



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 29 regjistër (JR)  
Datë 26.07.2024

Nr. 79 i vendimit  
Datë 04.11.2025

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 04.11.2025, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretar Gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Hektor Sinanaj, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 742, datë 13.03.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 42 i Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 62, 63, 65 vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë dhe Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe parashtrime, me anë të të cilave kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 742, datë 13.03.2024, të Komisionit të Pavarur

të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Hektor Sinanaj (në vijim subjekti i rivlerësimit/subjekti), gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, në bazë të nenit 179/b të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”) si dhe; Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), prej të cilave rezultoi si më poshtë.

2.1 ILDKPKI-ja, në përfundim të procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit aktin e kontrollit<sup>1</sup>, ku konstaton: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklaram të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2 AKSIK-ja ka përcjellë raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Hektor Sinanaj<sup>2</sup>, ku konstaton se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, duke konstatuar *përshtatshmërinë* në vazhdimin e detyrës.

2.3 KLGj-ja ka përcjellë raportin mbi analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, i cili është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklaramit bashkë me tri dokumente ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë këtë formular; (ii) pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënat nga burimet arkivore të KLGj-së.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, në përfundim të hetimit për të tri kriteret e rivlerësimit, me vendimin nr. 742, datë 13.03.2023, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Sipas çështjeve të shqyrtuara për secilin kriter, përfundimet e Komisionit janë si vijon.

<sup>1</sup> Akti kontrolli nr. {\*\*\*} prot., datë 12.03.2020.

<sup>2</sup> Raporti nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 24.10.2023, të KDZh-së. AKSIK-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 18.07.2023, ka informuar se nuk ndryshon konstatimi fillestar për përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit.

**3.1.** Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: (i) subjekti nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës; (ii) subjekti ka rezultuar me pamundësi financiare në vlerën totale (-) 28.902.386 lekë për krijimin e pasurive, si dhe nuk ka mundur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të tij; (iii) subjekti nuk ka paraqitur në mënyrë të saktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose përdorim të tij dhe personave të lidhur; (iv) për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

**3.2.** Për kriterin e kontrollit të figurës: subjekti i rivlerësimit Hektor Sinanaj ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

**3.3.** Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk është “i aftë” pasi ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim jo të drejtë, nuk ka respektuar të drejtat e palëve, nuk është eficient, si dhe ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit. Subjektit i rivlerësimit nuk ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

**3.4.** Nisur nga sa më sipër, lidhur me vlerësimin tërësor të çështjes, trupi gjykues vlerëson se duke marrë në konsideratë problematikat lidhur me kriterin e pasurisë, si dhe mangësitë e evidentuara në vlerësimin e aftësisë profesionale dhe denoncimet nga publiku, si më lart janë arsyetuar, subjekti i rivlerësimit ka cenuar me sjelljen e tij besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Për pasojë, ato çmohen në zbatim të nenit 61, pika 5 dhe pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

### **III. Shkaqet e ankimit**

4. Subjekti i rivlerësimit ushtroi ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”)<sup>3</sup>, kundër vendimit objekt gjykimi, duke ngritur shkaqe që lidhen me procesin e rregullt ligjor, për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e aftësive profesionale. Me ankimin dhe parashtrimet para seancës gjyqësore, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Kolegji: *Ndryshimin e vendimit nr. 742, datë 13.03.2024, të KPK-së dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Hektor Sinanaj, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.*

#### **A. Shkaqet e ankimit që lidhen me zbatimin e ligjit dhe parimet e procesit të rregullt ligjor**

5. Për sa i përket argumenteve për cenim të procesit të rregullt dhe të aspekteve procedurale të procesit të rivlerësimit të tij, subjekti i rivlerësimit pretendon për cenim të disa parimeve e të drejtave, konkretisht të: (i) parimit të gjykimit nga një trupë gjyqësore e pavarur dhe e paanshme; (ii) parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit; (iii) së drejtës për një vendim të arsyetuar; dhe (iv) respektimit të jetës private.

---

<sup>3</sup> Ankimi i administruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 18.07.2024, është paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

## ***B. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë***

6. Për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, argumentet e subjektit në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë.

6.1. Pas njohjes me vendimin e arsyetuar të Komisionit, ka konstatuar se të ardhurat nga *puna e avokatisë* për periudhën 1992-1999 janë njohur tërësisht në shumën 13.500.000 lekë, dhe në analizën financiare janë përlllogaritur shpenzime jetese në një marzh shumë të lartë prej 10.993.980 lekësh, një normë hipotetike, tërësisht abuzive dhe e pabazuar në asnjë kriter vlerësues. Me pretendimet se Komisioni nuk e ka njohur me këtë rezultat as në shpalljen e vendimit, se përcaktimi i shpenzimeve të jetesës është vendosur pas dhënies së vendimit të shkarkimit duke e privuar nga e drejta e mbrojtjes për të dhënë shpjegime lidhur me to, subjekti kërkoi prej Kolegjit riçeljen e shqyrtimit gjyqësor lidhur me shpenzimet e jetesës, të cilat, sipas tij, për periudhën 1992-2003, për pesë persona, duhet të llogariten bazuar në të dhënat e INSTAT, që përkojnë me vlerën 4.325.120 lekë.

6.2. Vlerësimi i Komisionit për të mospranuar të ardhurat nga emigracioni në Greqi në vitet 1991-1992 është i pabazuar, pasi janë paraqitur një sërë provash, si deklarata nga shtetas, banues në Greqi, që kanë punuar në të njëjtën kohë me të, si dhe fotografi të asaj kohe. Subjekti pretendoi se këto të ardhura janë të pamundura të vërtetohen me dokumentacion provues për shkak të kohës së largët dhe Komisioni duhet të vlerësonte deklaratimet e personave të tjerë dëshmitarë.

6.3. Mosmarrja në konsideratë e të ardhurave prej vitit 1983, me argumentin se në këtë periudhë nuk mund të krijoheshin kursime, është e gabuar, pasi ky argument bazohet në raste të përgjithshme, kurse në rastin e tij rrogën e mbante të gjithën për vete, pasi në familje ishin të gjithë të punësuar, dhe të ardhurat e kursyera i kanë shërbyer për ndërtimin që në fillimin e viteve 1990 të shtëpisë dhe ambienteve të zyrave, për vete dhe për t'i dhënë me qira.

6.4. Komisioni në mënyrë abuzive nuk ka njohur të ardhurat nga qiratë nga zyra avokatie, eksperti dhe biznesi, pavarësisht se njeh marrëdhënien e qirasë me një sërë subjektsh tatimore qysh në fillim të viteve 2000. Marrëdhënia e qirasë, mes bashkëshortes L. S. qiradhënëse dhe qiramarrës subjekte të regjistruara në organet tatimore, është deklaruar në deklaratat periodike vjetore, është faktuar me kontrata qiraje të thjeshta dhe noteriale pas ndryshimeve ligjore, janë vënë në dispozicion prova për pagesës së tatimit në burim, prandaj të ardhurat duhet të llogariten plotësisht në analizën financiare. Me provën e re të paraqitur me ankimin, shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, konfirmohet se subjektet për të cilët janë kërkuar të dhëna janë subjekte tatimore dhe për periudhën e cituar kanë shlyer detyrimet e tatimit në burim. Në këto kushte, Kolegji duhet të riçelë hetimin për rivlerësim të të ardhurave nga qiratë.

6.5. Të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti kopsht privat nuk janë vlerësuar drejt për vitet 2013-2014. Këto të ardhura janë deklaruar në mënyrë të saktë në deklaratimet periodike të pasurisë, në vlera më të larta krahasuar me ato që figurojnë në sistemin tatimor, mospërputhje që vjen për shkak të ndryshimit të menaxhimit të sistemit tatimor, nga pushteti vendor te Drejtorinë Rajonale të Tatimeve dhe pasaktësitë kanë qenë të pranishme në pjesën më të madhe të subjekteve tatimore në atë kohë.

6.6. Në lidhje me analizën financiare, subjekti pretendoi: (i) për kryerjen e saj Komisioni i është bazuar aludimeve dhe me gabime të rënda materiale; (ii) ka shtuar shpenzimet jetike duke mosvlerësuar asnjë rrethanë të provuar prej tij; (iii) shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit janë në kundërshtim me faktet, pasi në Itali e Greqi kanë qëndruar te të afërm, shpenzimet për pushime në vitin 2008 janë shtuar në vlerë të konsiderueshme; si dhe (iv) për vitet 2001-2003 nuk janë pasqyruar tërheqjet e depozitave bankare që ka pasur në atë periudhë, për të cilat ka paraqitur si provë shkresën e Raiffeisen Bank të datës 20.03.2023.

### ***C. Shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin për deklaratimet e pasurisë***

6.7. Në lidhje me vlerësimin e Komisionit *se nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasurinë, sipas pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës*, subjekti pretendon se është i papabazuar. Sipas subjektit: (i) pasuritë godinë trekatëshe me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup> dhe njësi me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup> dhe trualli i saj në Vlorë, janë deklaruar në detaje në të gjithë historikun e krijimit të tyre, si dhe është paraqitur dokumentacioni dhe shpjegimet përkatëse; (ii) lidhur me pasurinë shtëpi banimi me sipërfaqe trualli 162 m<sup>2</sup>, në Vlorë, vlerësimi i Komisionit se ka pasaktësi në deklaratimet periodike, lidhur me origjinën e krijimit të saj, ku dhurimin e 1/2 pjesë të saj nga vjehri e deklaroi në deklaratën *vetting*, duke penguar vlerësimin e plotë dhe të saktë të burimit të krijimit të saj, është tërësisht alogjik, pasi pasaktësia në deklaratën periodike fillestare është sqaruar në vijimësi në ILDKPKI; (iii) lidhur me automjetin tip “{\*\*\*}”, i është referuar çmimit të kontratës së blerjes, sa i përket çmimit përfundimtar është vënë në dijeni me informacionin e dhënë prej Komisionit, i cili ka llogaritur këstet e qirasë financiare së bashku me interesat bankare, për faktin që shumat e të gjithë kësteve ka rezultuar më e lartë se ajo e blerjes nuk mund të marrë informacion pasi subjekti tregtar e ka mbyllur aktivitetin.

### ***Ç. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale***

6.8. Lidhur me dokumentin nr. 1, vendimin penal nr. {\*\*\*}, datë 27.03.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Komisioni ka vlerësuar se nuk janë zbatuar dispozitat lidhur me gjykimin e shkurtuar, pa dhënë asnjë shpjegim dhe pa kryer asnjë hetim për sqarimin e dhënë prej tij se në këtë vendimmarrje të trupës gjyqësore të përbërë nga tre gjyqtarë, ai ka qenë në pakicë.

6.9. Lidhur me dokumentin nr. 2, vendimin civil nr. {\*\*\*}, datë 22.02.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vlerësimet se subjekti nuk ka kryer një proces gjykimi të bazuar në prova, ka mbyllur procesin e gjykimit mbi një akt ekspertimi me të meta, se vendimi përfundimtar nuk është i arsyetuar qartë dhe në mënyrë të kuptueshme, se mungon analiza e provave dhe arsyetimi logjik dhe se zgjidhja e kontratës në mënyrë të njëanshme nga pala paditëse është konsideruar në formën e vetëgjyqësisë duke ngatërruar konceptet e të drejtës civile me ato penale, Komisioni ka shfaqur qëndrime subjektive duke mos u bazuar në asnjë të dhënë konkrete.

6.10. Lidhur me vlerësimin e vendimeve të tjera gjyqësore, në të gjitha rastet, përfundimet e Komisionit janë stereotipe duke përsëritur që subjekti nuk parashtroi asnjë argument, ndërkohë që argumentet janë të qarta për sa i përket mënyrës së arsyetimit të gjyqtarit, vendimmarrja bazohet në bindjen e brendshme të gjyqtarit, për sa kohë prej tij është arsyetuar caktimi i një lloji dhe mase dënimi.

6.11. Prej Komisionit janë cituar dy procedime të mëparshme disiplinore ndaj tij, pa një arsye konkrete sesi këto masa të mëparshme mund të ndikonin në procesin e rivlerësimit, aq më tepër për t'i cituar si gjetje të mangësive profesionale të subjektit, sepse do të cenohesh parimi i gjësë së gjykuar.

6.12. Lidhur me denoncimet e cituara nga Komisioni, gjetjet e prezantuara janë shqyrtuar nga KLGj-ja, ku asnjë prej tyre nuk është gjetur e bazuar për konflikt interesi apo pretendime të tjera. Këto denoncime, krahasuar me numrin e çështjeve të gjykuara prej tij gjatë 24 viteve, janë në një numër të papërfillshëm, çka tregon besueshmëri të lartë të gjyqtarit të publiku, dhe se Komisioni ka arritur në konkluzione të nxituara për gjykime në kushtet e konfliktit të interesit, sipas argumenteve të tij lidhur me këtë çështje.

6.13. Lidhur me përfundimet e Komisionit, për *gjendje të konfliktit të interesit, se duhet të hiqte nga gjykimi i çështjeve në kushtet kur personi i lidhur (bashkëshortja) ka qenë qiradhënëse e zyrave të avokatëve që kanë përfaqësuar palët në çështje, se ekziston konflikt i interesit në dukje*, subjekti pretendon se ka mbajtur një qëndrim të paanshëm me palët në proces dhe nuk ka pasur asnjë të dhënë që të dyshohesh se gjykata mund të ishte e njëanshme. Në lidhje me testin objektiv të paanshmërisë, nuk cenohet nga kjo situatë, pasi: (i) nuk ka asnjë raport përfitimi mes gjyqtarit dhe përfaqësuesve të palëve, sepse pagesa mujore e qirasë që administronte bashkëshortja ishte vetëm për përdorimin e zyrave, përfitimi ishte më shumë për avokatët qiramarrës të një ambienti në afërsi të gjykatës, qiramarrësi ishte i zëvendësueshëm nëse largohesh, pra, gjyqtarit nuk do t'i krijohej asnjë dëm ekonomik; (ii) Komisioni nuk ka hetuar dhe vlerësuar në mënyrë të plotë situatën, nuk ka vlerësuar me parimin e proporcionalitetit, nuk ka marrë në konsideratë faktin se ILDKPKI-ja dhe asnjë organ tjetër kompetent asnjëherë nuk është shprehur se ka gjendje të konfliktit të interesit, si dhe faktin se për të shmangur çdo debat dhe pasi është informuar për këtë çështje, që ishte e diskutueshme nga organet si KPK dhe ILD, ka filluar të kërkojë heqjen dorë nga çështjet ku përfaqësues kanë qenë avokatët qiramarrës.

#### **IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

##### **A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegji**

###### *i. Juridiksioni i Kolegjit*

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### *ii. Legjitimitimi i ankuesit*

8. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar

pranë Komisionit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*iii. Forma e gjykimit*

9. Në parashtrime lidhur me shkaqet e paraqitura në ankim, të paraqitura përpara seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit konfirmoi sa parashtruar në ankimin e drejtuar Kolegjit, duke bashkëlidhur disa dokumente, si edhe një kërkesë për marrje të provave të reja në gjykim, të akteve shkresore të paraqitura më ankimin<sup>4</sup> dhe me parashtrimet<sup>5</sup>.
10. Lidhur me kërkesat e subjektit për marrjen e provave të reja. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit, si rregull, kryhet në dhomën e këshillimit. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi. Trupi gjykues shqyrtoi kërkesat e subjektit të rivlerësimit për të pranuar në cilësinë e provave të reja aktet e sjella me ankimin dhe me parashtrime, dhe siç analizohet gjerësisht në vijim, pavarësisht se në pikëpamje formale, plotësojnë kriteret e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, në analizë të rrethanave që rezultojnë nga çështja në këndvështrim të parashikimeve ligjore respektive, informacioni dhe të dhënat e përfuara prej tyre, nuk rezultojnë të kenë ndikim në zgjidhjen e çështjes, e për pasojë ato u refuzuan të merren si të panevojshme. Në vijim, analiza dhe vlerësimi i trupit gjykues.

**10.1.** *Së pari*, lidhur me shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë (në vijim “DRT Vlorë”) me nr. {\*\*\*} prot., datë 16.07.2024, me lëndë “Dërgojmë përgjigje individit”, paraqitur bashkëlidhur ankimit, subjekti i rivlerësimit argumenton se: [...]..i bëhet me dije në këtë moment këtij Kolegji si provë e re shtesë për interes në dhënien e drejtësisë për shkak të qëndrimit neglizhues dhe jobashkëpunues të Komisionit, që nuk e dimë pse nuk ka pranuar asnjë nga provat që faktojnë se qiramarrësit kanë qenë subjekte tatimore. Nuk mund të parashikonim asnjë moment se rezultati i Komisionit do të rezultonte absurd duke quajtur se qiramarrësit kanë qenë jo persona fizik tregtar, por individ, i pabazuar në provat dhe faktet që kemi paraqitur. Prandaj, në kushtet e një qëndrimi të tillë të Komisionit, kemi marrë informacion me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.07.2024, për disa nga subjektet qiramarrës, duke rezultuar se kishin paguar tatimin në burim për periudhën që kemi cituar në kërkesë [...] nuk mund të merrnim informacion të detajuar për aq sa rezulton nga sistemi për shkakun se DRT-ja Vlorë për këto subjekte qiramarrës nuk mund të na informojë për të dhënat e tyre, sepse i quan sensitive. Për verifikimin e këtij fakti, Komisioni as nuk ka kaluar barrën e provës, por edhe nuk ka bërë asnjë përpjekje për verifikim. [...]. I gjithë ky grup pretendimesh, mbi të cilin subjekti pretendon dhe kërkon që shkresa e DRT-së Vlorë të kualifikohet si provë e re, u vlerësua prej trupit gjykues i pabazuar, sipas analizës në vijim.

**10.1.1.** Bashkëlidhur deklaratës vetting, lidhur me deklarimin “Të ardhura nga dhënia e ambienteve të pasurive të paluajtshme 1,2,3,4<sup>6</sup> me qira në periudhën 2004-2016, sipas

<sup>4</sup> Subjekti bashkëlidhur ankimit ka depozituar shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë me nr. {\*\*\*} prot., datë 16.07.2024, kopje e notuar me nr. {\*\*\*} rep., datë 16.07.2024, noter A. XH.

<sup>5</sup> Me parashtrimet, në Kolegji, subjekti depozitoi: vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. {\*\*\*}, datë 25.10.2022; vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë nr. {\*\*\*}, datë 05.11.2024; deklaratë (konfirmim) me nr. {\*\*\*} prot., datë 27.02.2024, e Kryetarit të Dhomës së Avokatisë Vlorë, av. D. B., si dhe deklaratë e datës 28.02.2024 e koordinatores së Urdhrit të Psikologut për Qarkun Vlorë, psikologe V. H., kopje të notuara me nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2024.

<sup>6</sup> Pasuria 1: shtëpi banimi në një sip. trualli 162 m<sup>2</sup> në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë; pasuria 2: apartament në Pall nr. {\*\*\*}, lagja “{\*\*\*}” Vlorë, 2+1, me sipërfaqe. 43.4 m<sup>2</sup> (me kontratë privatizimi); pasuria 3: sip. 150 m<sup>2</sup> godinë

*kontratave të qirasë gjithsej në shumën 8.522.000 lekë dhe 36.000 euro*”, të ardhura të cilat, gjithashtu, deklarohen si burim krijimi i disa pasurive të deklaruara në deklaratën *vetting*<sup>7</sup>, subjekti ka paraqitur si dokumentacion justifikues disa kontrata qiraje, nga viti 2004 e në vijim, të thjeshta deri përpara vitit 2015, disa prej të cilave fotokopje e, më pas, të lidhura përpara noterit. Në këto kontrata, qiramarrësit pasqyrohen si individë, nuk ka parashikime lidhur me detyrimin tatimor dhe çmimi i qirasë mujore parashikohet që do të paguhet *cash*. Për rrjedhojë, që me depozitim e deklaratës *vetting*, me dokumentacionin justifikues ligjor bashkëlidhur saj, subjekti nuk ka përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore, konkretisht të të provuarit me dokumentacion ligjor të shlyerjes së detyrimeve tatimore lidhur me të ardhurat e deklaruara nga qiraja, në përmbushje të parashikimit në Aneksin e Kushtetutës, nenit D, pika 3 se: *“Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”*, materializuar në dispozitat e ligjit nr. 84/2016 dhe të qartësuar në Udhëzimin e ILDKPKI-së, pikën 23 të tij se: *“Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga qiraja, të shoqërohet me vërtetimin përkatës për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga qiraja”*.

**10.1.2.** Nga aktet në dosjen gjyqësore, konstatohet se edhe gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, për të ardhurat e deklaruara nga qiraja, subjekti ka dështuar të provojë pagimin e detyrimeve tatimore, pavarësisht pyetjeve të adresuara prej Komisionit gjatë hetimit administrativ, si edhe në përgjigje të barrës së provës së kaluar me raportin për rezultatet e hetimit administrativ kryesisht. Konkretisht, gjatë hetimit administrativ, për kërkesat e Komisionit, lidhur me qartësimin se prej kujt janë paguar detyrimet tatimore, në kushtet e mungesës së parashikimeve në kontrata, si edhe për provueshmërinë e pagimit të tyre, subjekti është mjaftuar me deklarin se tatimi në burim është paguar nga qiramarrësit dhe se ky detyrim është mbajtur parasysh në marrëveshjen mes qiramarrësve, duke zbritur gjithmonë çmimin e qirasë për efekt të llogaritjes edhe të pagimit nga qiradhënësi të tatimit në burim (pyetëtori standard); se qiramarrësit kanë qenë subjekte me aktivitete tregtar të regjistruar me NIPT-t, rrjedhimisht pagesat për tatimin në burim paguheshin detyrimisht nga subjekti biznes i gjendur edhe në mbikëqyrje nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, se nga verifikimi në adresën elektronike të QKB-së, subjektet qiramarrës rezultojnë se kanë deklaruar edhe adresën e zyrave që kanë pasur pranë godinës në lagjen “{\*\*\*}”, që janë dhënë me qira dhe, rrjedhimisht, pagesat për tatimin në burim kanë qenë në monitorim nga organet tatimore (pyetëtori 2). Ndërsa, në raportin e Komisionit për rezultatin e hetimeve kryesisht, pas pasqyrimin të parashikimeve të kuadrit ligjor të zbatueshëm në rastin e marrëdhënieve të qirasë, në aspekt të shlyerjes së detyrimeve tatimore dhe palës përkatëse që i buron ky detyrim<sup>8</sup>,

---

*njëkatëshe, ndërtuar nga fundi i vitit 1992, rikonstruktuar me leje ndërtimi {\*\*\*}, datë 13.07.2001 dhe {\*\*\*} datë 15.05.2001 sheshit ndërtimit dhënë nga Bashkia Vlorë me destinacion banesë 2 kat + zyra në katin e parë, përshtatur 9 zyra, kati përdhe kopsht fëmijësh; pasuria 4: njësi 60 m<sup>2</sup>dhe truall (blerë në vitin 2010 ndërtuar shtesë kati , e legalizuar. Në katin e I-rë dhe të II-të janë bashkuar ambientet e pasurisë 3 dhe pasurisë 4).*

<sup>7</sup> *Pasuritë e deklaruara në deklaratën vetting me nr. {\*\*\*}dhe depozita bankare të deklaruara me nr. {\*\*\*},{\*\*\*} dhe {\*\*\*}.*

<sup>8</sup> *Ligji nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në nenin 8 “E ardhura e tatueshme”, si dhe sqarimet në pikën 2.3.6. të Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, i ndryshuar, përcaktohet se: “[...] a) në rastin e marrëdhënies së qiradhënies të lidhur midis dy individëve dhe kur nuk është përcaktuar ndryshe në kontratë, detyrimi tatimor mbi vlerën e qirasë do të përmbushet nga individi përfitues. b) ndërsa në rastin e marrëdhënies së qiradhënies të lidhur midis një individi dhe personi (të tatueshëm) juridik, sipas përcaktimeve në nenin 33 të ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, detyrimi tatimor do të përmbushet nga personi juridik, vetëm nëse në kontratë është përcaktuar ndryshe. [...]”.*

analizohet se [...] kontratat përgjithësisht janë verbale dhe ashtu siç shprehet subjekti në deklaratën vetting, vetëm 3 vitet e fundit janë noteriale. Në këto kontrata nuk përcaktohet se kush ka përgjegjësinë tatimore dhe ato janë lidhur midis personave fizik, jo juridik sipas përcaktimeve të ligjit. Sa më lart, nuk rezulton të jenë shlyer detyrimet tatimore për këto të ardhura të fituara nga kontratat e qirasë dhe as nuk rezulton të jetë mbajtur tatimi në burim nga palët. Për sa më lart, Komisioni nuk ka përfshirë në analizën e tij të ardhura nga qiraja. [...]. Gjithashtu, me këtë raport, subjektit i ka kaluar barrë prove lidhur me pamundësitë financiare të rezultuara për krijimin me burime të ligjshme financiare të disa prej pasurive, për të cilat të ardhurat nga qiratë ishin deklaruar ndër burimet kryesore të krijimit të tyre. Në përgjigje të barrës së provës, me paraqitjen e deklaratave noteriale të 16 qiramarrësve, të cilët deklarojnë se kontratat e qirasë të nënshkruara prej tyre, noteriale ose jo, janë kryer për efekt të ushtrimit të aktivitetit të tyre profesional ose tregtar, të regjistruar në organet tatimore, subjekti ka pretenduar se provohet se këta subjekte qiramarrës kanë qenë edhe subjekt përgjegjës i deklaramentit tatimor për tatimin në burim të të ardhurave nga qiraja; se qiradhënësit nuk kanë detyrimin për plotësimin e deklaratave tatimore, kur subjektet qiramarrës ushtrojnë aktivitet tregtar/profesional të regjistruar në organet tatimore; se deklarata të tilla janë plotësuar, në bazë të dijenisë, nga subjektet qiramarrës, çka i bën të ardhurat nga qiratë të justifikueshme me pagesë të tatimeve. Për sa më sipër, *së pari*, përpos se gjatë hetimit administrativ, me pyetjet e adresuara, subjektit i është kërkuar qartazi të shpjegojë lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga qiratë, raporti për rezultatet e hetimit administrativ kryesisht shoqëruar me analizën financiare paraprake dhe metodologjinë e hartimit të saj, ku të ardhurat nga qiratë nuk janë përfshirë, gjetjet dhe barra e provës së kaluar, tregojnë pa asnjë ekuivok se subjekti ka qenë i qartë se deri në këtë moment procedural kishte dështuar të provonte ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara nga qiraja. *Së dyti*, në Komision, specifikisht në përmbushje të barrës së provës, si një moment procedural i një rëndësie të veçantë që i paraprin vendimmarrjes, subjekti ka dështuar të provojë ligjshmërinë e të ardhurave nga qiraja, duke zgjedhur të anashkalojë adresimin e drejtpërdrejtë në institucionin përkatës, DRT-në Vlorë, si dhe të paraqesë dokumentacion jo provues për pagesën e tatimeve nga subjektet qiramarrës, sikundër ai pretendon se ka ndodhur. Konkretisht, në pyetësonin standard prej tij deklarohen si qiramarrës 25 individë, ndërkohë dokumentacioni i paraqitur me pyetësonë, shkarkuar nga faqja zyrtare e QKB-së, referon për 7 persona fizikë, tre të regjistruar pas lidhjes së kontratës së qirasë, për njërin prej tyre marrëdhënia e qirasë është jashtë periudhës së rivlerësimit<sup>9</sup>; në përgjigje të barrës së provës, ku qartësisht Komisioni është shprehur për shkakun e mospërfshirjes së të ardhurave nga qiratë, me pasojë balancë negative/pamundësi financiare për krijimin e pasurive, subjekti është mjaftuar me paraqitjen e deklaratave noteriale të qiramarrësve. Konsideruar se që në fillim të procesit të rivlerësimit kalimtar, në jurisprudencën e tyre, institucionet e rivlerësimit kanë mbajtur një qëndrim të konsoliduar për vlerën e zbehtë provuese të deklaratave noteriale të hartuara gjatë këtij procesi, zgjedhja e subjektit që në procesin e tij të rivlerësimit, në vitin 2024, të synojë që përmes deklaratave noteriale të hartuara gjatë procesit, të provojë ligjshmërinë e të ardhurave nga qiraja, të deklaruara në një vlerë të konsiderueshme, përpos se në mospërputhje me parashikimet e kuadrit kushtetues e ligjor që normojnë këtë proces, duket edhe e paarsyeshme. Për sa provohet, se ka qenë zgjedhje e vetë subjektit për të mosshfrytëzuar mundësitë ligjore gjatë procesit

<sup>9</sup> F. H., i regjistruar në datën 03.02.2016, subjekti deklaroi periudhë qiraje 02.11.2017-02.11.2009, për rrjedhojë periudhë parelevancë për rivlerësimin e subjektit.

administrativ në Komision për të provuar pretendimet për shlyerje të detyrimeve tatimore prej qiramarrësve, pretendimet e tij se për të ardhurat nga qiraja *Komisioni as nuk ka kaluar barrën e provës, por edhe nuk ka bërë asnjë përpjekje për verifikim*, për më tepër që Komisioni ka marrë informacion nga DRT-ja Vlorë, vlerësohen haptazi të pabazuar.

**10.1.3.** Në shkresën e DRT-së Vlorë nr. {\*\*\*} prot., datë 16.07.2024, pasqyrohet se: [...] *Në zbatim të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 15.07.2024, lëshuar nga DRT-ja Vlorë, është ushtruar verifikimi nga zyra mbi kërkesën e individëve Hektor Sinanaj dhe L. S. [...]. Kërkesa e individëve është për vendosjen në dispozicion të informacionit rreth të dhënave në sistemin tatimor në lidhje me pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale nga qiraja (tatimi në burim), sipas tabelës më poshtë [...]. Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju konfirmojmë se subjektet për të cilët keni kërkuar të dhëna janë subjekte tatimorë, ku rezulton se për periudhat e cituara nga ju, janë shlyer detyrimet e tatimit në burim. Për të dhënat e tjera të kërkuara nga ju, nuk mund t'ju vendosim në dispozicion të dhëna, pasi janë të dhëna sensitive, bazuar në nenin 25 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008. [...].*

*Së pari*, duke abstraguar nga fakti se në kontratat e qirasë, qiradhënësit pasqyrohen si individë dhe jo si persona fizikë, referuar përmbajtjes së shkresës sipërcituar, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson: (i) në shkresë listohen 14 subjekte fizikë, informacioni për të cilët i korrespondon periudhës kohore prill 2003-dhjetor 2016, ndërsa subjekti deklaroi marrëdhënie qiraje me 25 individë dhe të ardhura nga qiratë që prej vitit 2000; (ii) për disa prej subjekteve të listuar, ka mospërputhje të periudhës për të cilën informohet se kanë shlyer tatimin në burim me periudhën e marrëdhënies së qirasë, sipas deklaramit të subjektit; (iii) mospasqyrimi i shumës së detyrimit tatimor të shlyer nga secili prej subjekteve të listuar passjell pamundësi për të analizuar nëse detyrimi tatimor përkon me vlerën e qirasë, sipas kontratës së qirasë, thënë ndryshe pamundësi për të analizuar ligjshmërinë e shumave të të ardhurave nga qiratë, të deklaruara prej subjektit.

*Së dyti*, referuar ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 25 “Konfidencialiteti”, në pikën 4 parashikohet: “*Kushti i ruajtjes së konfidencialitetit përfundon në rastet kur tatimpaguesi heq dorë, me shkrim, nga e drejta e tij për ruajtjen e konfidencialitetit dhe për aq sa është e lejuar në deklarin e bërë nga tatimpaguesi*”. Në kuptim të këtij parashikimi, subjekti duket se ka pasur mundësinë për të shmangur kufizimet ligjore, lidhur me marrjen e informacionit për masën e detyrimit tatimor të shlyer në burim, të paktën për 14 subjektet që ka listuar në kërkesën që i ka adresuar DRT-së Vlorë, për më tepër, nisur edhe nga gatishmëria e dëshmuar prej këtyre subjekteve për të lëshuar deklarata noteriale.

*Së treti*, pavarësisht se në kuptim të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, shkresa e DRT-së Vlorë nr. {\*\*\*} prot., datë 16.07.2024, nuk e kalon testin për t’u pranuar si provë prej Kolegjtit, dhe se informacioni i përcjellë është i pamjaftueshëm për të konkluduar lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave nga qiratë për marrëdhënien e qirasë me subjektet tregtare të listuar në të, trupi gjykues, për një qëndrim garantist, në shqyrtimin e shkaqeve të ankimit lidhur me themelin, siç analizohet gjerësisht në vijim, konstatoi se edhe nëse do të konsideroheshin të ligjshme të ardhurat nga qiratë e përfituara prej këtyre subjekteve, sipas një vlerësimi harmonik të të dhënave në këtë shkresë dhe i atyre të dala nga aktet e tjera të administruara gjatë hetimit, analiza financiare do të rezultonte sërish me një balancë negative të konsiderueshme, duke mos

e ndryshuar konkluzionin se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

**10.2.** Lidhur me vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë nr. {\*\*\*}, datë 05.11.2024, paraqitur prej subjektit me parashtrime, me paditës subjektin e rivlerësimit, të paditur DRT-ja Vlorë, person i tretë Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë, me të cilin është vendosur “Pranimi i kërkesë padisë. Detyrimin e palës së paditur DRT Vlorë të njohë vërtetësinë e dokumenteve [...]”, trupi gjykues, edhe duke abstraguuar nga mosplotësimi i kriterëve formale të paraqitjes së këtij akti, në kundërshtim me atë që parashikon neni 49 i ligjit nr. 49/2012, konstaton dhe vlerëson si vijon. *Së pari*, në përmbajtje të këtij vendimi, i cili ka vulën e Zyrës Postare, datë 25.12.2024, nuk ka shënim që palët ndërgjyqëse të kenë ushtruar ankim, rezulton se subjekti i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë me kërkesë padi me objekt “Njohjen e vërtetësisë së dokumenteve shkresore”, pasi DRT-ja Vlorë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 14.02.2024, me lëndë “Kthim përgjigje”, ka refuzuar njohjen e pagesave të kryera për periudhën 1992-2000, me arsyetimin se dokumentet/shkresat objekt gjykimi nuk mund të arkivohen, pasi nuk mund të provohet vërtetësia e tyre. *Së dyti*, trupi gjykues evidenton se qysh në momentin e depozitimit të deklaratës *vetting*, subjekti ka qenë në dijeni se DRT-ja Vlorë<sup>10</sup> nuk vërtetonte kryerjen e pagesës së tatimeve për të ardhurat nga avokatia për periudhën 1992-1997, por nuk ka ndërmarrë veprime për të provuar gjyqësisht vërtetësinë e dokumenteve bankare të disponuara prej tij, duke dëshmuar edhe në këtë rast, sikundër edhe për të ardhurat nga qiratë, neglizhencë për të siguruar dokumentacionin justifikues ligjor, në mos përmbushje të detyrimeve të buruara nga kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit. *Së treti*, Komisioni ka çmuar se rezulton e provuar se subjekti ka ushtruar profesionin e avokatit për periudhën 1992-1999, duke u regjistruar me vendimin e gjykatës nr. {\*\*\*}, datë 05.05.1992, si person fizik, me aktivitet avokat, në organet tatimore rajonale me kod fiskal nr. {\*\*\*}, pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore për pagën minimale, mandatpagesat pranë Bankës së Shtetit dhe Bankës së Kursimeve, mandatpagesat për kryerjen e pagesës pranë zyrës së tatimeve etj., dhe se në deklaratën e parë (viti 2003) ka bërë deklaram të detajuar për të ardhurat e realizuara për çdo vit të kryerjes së këtij aktiviteti dhe nga institucionet konfirmohen pagesat për shlyerjen e detyrimeve tatimore prej tij në vitet 1998-1999. Në vijim, duke vlerësuar se nisur nga koha e gjatë e arkivimit të të dhënave, subjekti ka mundësi të provojë shumat konkrete të përfituara prej tij apo/dhe shumat e detyrimeve tatimore të shlyera prej tij, mbështetur në praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit mbi të ardhurat nga avokatia, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat *neto* të llogaritura me marzhin e fitimit prej 90% për qarkullimin minimal prej 2.000.000 lekësh në vit, për periudhën shtator 1992-1999, për të cilën subjekti nuk ngre ndonjë pretendim. Për sa më lart, marrja e këtij vendimi gjyqësor si provë, vlerësohet prej trupit gjykues e panevojshme në kuptim të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “a” ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>10</sup> Me deklaratën *vetting*, subjekti ka paraqitur shkresën e DRT-së Vlorë “kthim përgjigje” me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.01.2017, ku pasqyrohet: “[...] nga verifikimet e kryera në zyrën e kontabilitetit, rezulton se z. Hektor Sinanaj i regjistruar me vendim gjykate nr. {\*\*\*}, datë 05.05.1992, si person fizik me aktivitet avokat dhe kod fiskal nr. {\*\*\*}, për të cilin konfirmohet pagesa e kryera në këtë zyrë në vitin 1998 (60.000 lekë) dhe 1999 (35.000 lekë). Nga ana juaj janë paraqitur pagesat nga viti 1992 deri në mars 2000. Këto dokumente nuk mund të pranohen të futen në dosjen tuaj fizike pranë arshivës së DRT-së Vlorë sepse janë dokumente të cilat duhej të na viheshin në dispozicion që në momentin që janë kryer pagesat pranë bankave. Këto dokumente mund t’i paraqisni vetë, pranë institucioneve që ju kërkohet me pretendimin që janë origjinale, sepse DRT-ja Vlorë e ka të pamundur të shprehet lidhur me originalitetin e tyre. [...]”.

**10.3.** Lidhur me vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. {\*\*\*}, datë 25.10.2022, të paraqitur me parashtrime, subjekti pretendon se ky vendim i është vënë në dispozicion nga Gjykata e Lartë me vonesë duke mos arritur të paraqitet dhe shqyrtohet nga Komisioni si provë. Referuar vendimit të sipërcituar, çështja e shqyrtuar në dhomë këshillimi, me objekt “Ankim kundër vendimit të pushimit të çështjes penale nr. {\*\*\*/2015, datë 25.05.2025, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier”, ka pasur ankues shtetasin TH. B., kundër Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe palë të interesuar subjektin e rivlerësimit. Referuar pozitës procedurale të subjektit, nuk duket e besueshme që gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, ai nuk e ka disponuar këtë akt dhe, në Kolegj, nuk ka paraqitur asnjë provë shkresore për të provuar kohën kur ky vendim i është vënë në dispozicion. Për më tepër, nga aktet në dosjen gjyqësore, nuk rezulton që subjekti ta ketë pretenduar paraqitjen e tij në funksion të të provuarit të ndonjë çështje apo gjetjeje të rezultuar nga hetimi administrativ kryesisht. Konkretisht, në seancën dëgjimore të datës 11.03.2024, subjekti ka kërkuar përjashtimin e trupit gjykues, me argumentin se ka kryer shkelje të rënda procedurale ndaj procesit duke renditur ndër to se *nuk i është përgjigjur kërkesave të subjektit ndaj pretendimeve për procesin, si kërkesa për pezullimin e procedurës administrative deri në përfundimin e procesit gjyqësor të Gjykatës Administrative për konfirmimin e dokumenteve të Bankës Shtetërore për pagesën e tatimeve të subjektit të avokatisë në vitet 1992-1997*, kërkesë e shqyrtuar nga një trup tjetër gjykues i caktuar me short, i cili ka disponuar me vendimin nr. {\*\*\*} prot., datë 11.03.2024, duke mos e pranuar atë. Pavarësisht pengesës procedurale, në kuptim të nenit 49 i ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon paraqitjen e parashtrimeve me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, si një mjet procedural, i cili nuk legjitimon përdoruesit e këtij mjeti të paraqesin dhe akte me kërkesën për t’u administruar si provë, trupi gjykues e vlerësoi këtë vendim edhe në kuptim të neneve 45 e 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me ndikimin që ai mund të kishte për ndonjë nga çështjet e trajtuara në vendimin objekt shqyrtimi dhe e konsideroi marrjen e tij të panevojshëm për zgjidhjen e çështjes, sipas parashikimit të nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Analiza e trupit gjykues është si vijon.

**10.3.1.** Lidhur me pretendimin e subjektit se [...] në vendimin e Komisionit është cituar vendimi nr. {\*\*\*}, datë 25.10.2022, i Gjykatës së Lartë, por nuk është ndalur në analizën që i është bërë ligjshmërisë së pasurisë në përmbajtje të këtij vendimi. Në këtë vendim është zhvilluar hetimi në lidhje me origjinën e krijimit të pasurisë të llojit godinë 3 kate në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, në konkluzion të së cilit ka rezultuar se pasuria ka qenë e krijuar konform të drejtave pronësore të ligjshme dhe proceseve administrative të rregullta [...], trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon. Së pari, lidhur me pasurinë godinë 3-katëshe, në Vlorë, në vendimin e Komisionit pasqyrohet si kallëzimi penal i shtetasit TH. B., kufitar në lindje me subjektin në këtë godinë, ndaj shtetasit Hektor Sinani në vitin 2015, i depozituar në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila e ka dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, i cili e ka kallëzuar për ndjekje penale shtetasin Hektor Sinanaj, për mënyrën e fitimit dhe regjistrimit të zyrës ku ai punonte më parë, për mënyrën e regjistrimit në ZVRPP (në lidhje me kufitarët), për pronësinë e truallit mbi të cilin subjekti ka ndërtuar zyrën e, më tej, godinën trekatëshe, dhe për falsifikim të kufitarëve të pronës së tij. Gjithashtu, pasqyrohet vendimi i Prokurorisë nr. {\*\*\*/2015, datë 25.05.2015, e cila ka vendosur pushimin e çështjes

penale, si dhe vendimet gjyqësore të gjykatave<sup>11</sup>, ku kallëzuesi TH. B. është drejtuar me ankim për prishjen e vendimit të prokurorisë dhe urdhërimin e vijimit të hetimeve, pasi hetimi nuk është i plotë. Në fashikullin e Komisionit rezultoi e administruar dosja penale që i përket procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2015, për kallëzimin penal të shtetasit TH. B., aktet e hetimit të zhvilluar, si dhe vendimi i Prokurorisë nr. {\*\*\*}/2015, datë 25.05.2015, e cila ka vendosur pushimin e çështjes penale, vendim i cili i është gjendur i drejtë dhe lënë në fuqi nga gjykatat në të tre nivelet. *Së dyti*, referuar vendimit të Gjykatës së Lartë, e cila duke vlerësuar se rekursi i paraqitur nga ankuesi TH. B. kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur mospranimin e tij, rezultoi se në pjesën “Rrethanat e çështjes” pasqyrohen të plota si kallëzimi i shtetasit TH. B., hetimi i kryer prej organit të Prokurorisë, arsyetimi dhe vendimi i saj, si dhe arsyetimi e vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe i Gjykatës së Apelit Vlorë. Për rrjedhojë, në kuptimin substancial, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk sjell të dhëna të ndryshme, përpos atyre të rezultuara prej akteve të administruara në dosjen gjyqësore.

**10.3.2.** Në vendimin e Komisionit janë pasqyruar deklaratimet e subjektit si gjatë hetimit administrativ mbi mënyrën e përfitimit të truallit mbi të cilin është ndërtuar godina 3-katëshe, si dhe ato në përgjigje të barrës së provës – *mbetet e paqartë mënyra e përfitimit të truallit në vitin 1992, mbi të cilin më vonë u ndërtua godina aktuale 3-katëshe*, për të cilat Komisioni ka vlerësuar se subjekti, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk arriti të qartësojë mënyrën e fitimit të pronësisë mbi këtë truall, duke e lënë të pavlerësuar në mënyrë të plotë këtë pasuri për sa i përket aktit ligjor të përfituar. Në përfundim, Komisioni nuk rezultoi t’i ketë dhënë pasojë subjektit lidhur me këtë çështje, duke konkluduar se për këtë pasuri, subjekti nuk arriti të provojë se burimet për krijimin kanë qenë ligjshme, referuar standardit dhe kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Sa më sipër, marrja e këtij vendimi gjyqësor si provë, vlerësohet prej trupit gjykues e panevojshme në kuptim të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “a” të ligjit nr. 84/2016.

**10.410.4.** Lidhur me deklaratën (konfirmim) me nr. {\*\*\*} prot., datë 27.02.2024 dhe deklaratën e datës 28.02.2024, përmes së cilave avokatë të Dhomës së Avokatëve Vlorë deklarojnë për mospasje raporte të ndërsjella interesash materiale me subjektin e rivlerësimit, si dhe psikologjia ligjore/koordinatore e Urdhrit të Psikologut në Qarkun e Vlorës, deklaroi se nga marrja e detyrës (nëntor 2021) nuk ka marrë asnjë ankesë nga anëtarët e urdhrit të psikologut të degës që përfaqëson, referuar datës së përpilimit të tyre, subjekti i ka disponuar gjatë kohës që zhvillohej procesi në Komision. Për rrjedhojë, këto akte nuk gëzojnë cilësinë e provave të reja, por çmohen edhe të panevojshme në kuptim të parashikimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “a” të ligjit nr. 84/2016.

**10.5.** Në këndvështrim të gjithë konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe në vlerësim të gjithë pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk identifikoi shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të diktonin formën e gjykimit në seancë gjyqësore publike

---

<sup>11</sup> Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nr. {\*\*\*}, datë 29.09.2015, që ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit TH. B. me objekt kundërshtimin e vendimit të prokurorisë “Për pushimin e procedimit penal të kallëzimit penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2015” dhe urdhërimin e vijimit të hetimeve, pasi hetimi nuk është i plotë”; vendimi nr. {\*\*\*}, datë 15.06.2017, i Gjykatës Apelit Vlorë, që ka vendosur: “Lënie në fuqi të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 29.09.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe se Gjykata e Lartë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 25.10.2022, ka vendosur: “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga ankuesi TH. B.”.

e, po ashtu, nuk evidentoi konstatim të gabuar të situatës faktike në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegj për korrigjimin e tyre, siç pretendon subjekti i rivlerësimit. Për pasojë, trupi gjykues vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit dhe në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit në Komision.

### ***B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni***

11. Subjekti i rivlerësimit pretendon për cenim të procesit të rregullt ligjor, për shkak të cenimit të një sërë parimesh e të drejtash, konkretisht: të gjykimit nga një trupë gjyqësore e pavarur dhe e paanshme, të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, për një vendim të arsyetuar, si dhe cenim të respektimit të jetës private. Trupi gjykues i mori në analizë të gjitha këto pretendime nën dritën e dispozitave kushtetuese dhe ligjore përkatëse dhe arriti në përfundimin që asnjë prej pretendimeve të subjektit nuk qëndron. Nga analiza e kryer mbi bazën e akteve në dosjen gjyqësore, rezulton se procesi i kryer për subjektin e rivlerësimit ka qenë në përputhje dhe në përmbushje të gjithë garancive kushtetuese, ligjore e konvatore për një proces të rregullt ligjor. Në vijim analiza e trupit gjykues.

11.1. Lidhur me pretendimin për cenim të parimit të gjykimit nga një trupë gjyqësore e pavarur dhe e paanshme, shkaqet e parashtruara prej subjektit dhe vlerësimi i trupit gjykues për to janë si vijon.

11.1.1. Lidhur me pretendimin se *arsyet për të cilat Komisioni citon se subjekti i rivlerësimit është bërë shkak për vonesën e procesit, janë abuzive dhe nuk ka pasur asnjë vonesë të shkaktuar prej tij, pasi në kërkesën për revokim të dorëheqjes nga mandati i gjyqtarit ka sqaruar arsyet përkatëse, tregojnë se Komisioni nuk ka qenë i pavarur nga ndikimi mediatik*, konstatohet se subjekti i referohet raportit të Komisionit për rezultatet e hetimit administrativ<sup>12</sup>, ndërsa në vendimin objekt shqyrtimi, në pjesën “Qëndrimi dhe mendimi i subjektit të rivlerësimit”, Komisioni ka vlerësuar se gjatë gjithë procesit të rivlerësimit ndaj tij, subjekti ka qenë bashkëpunues duke u përgjigjur dhe dërguar dokumentacion dhe shpjegimet përkatëse, sipas kërkesës së Komisionit, konform nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Lidhur me pretendimin se *Komisioni nuk ka qenë i pavarur nga ndikimi mediatik e se në punën e tij kanë ndikuar denoncimet ndaj subjektit të transmetuara në emisionin “{\*\*\*}”, në TV Klan, nga aktet në dosjen gjyqësore rezulton se kopja e CD-së për pamjet e transmetuara e të bëra publike është dërguar nga ky televizion në Komision me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 07.11.2023. Nga analiza e këtij denoncimi publik, janë evidentuar problematika lidhur me deklarimin e pasurive dhe konfliktin e interesit, të cilat janë në kuadër të procesit të rivlerësimit, çështje që kanë rezultuar edhe nga hetimi administrativ dhe janë trajtuar prej Komisionit në kuadër të vlerësimit*

---

<sup>12</sup> Në raport, Komisioni shprehet se: “[...] Duket se subjekti i rivlerësimit, gjatë procesit të rivlerësimit nuk është treguar bashkëpunues, duke u përpjekur të shtyjë hetimin administrativ dhe të ndikojë në vonesën e procesit të tij të rivlerësimit duke dhënë dorëheqjen prej këtij procesi me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 08.01.2024 dhe më pas duke e revokuar atë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 18.01.2024. Sjellja e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, ka vështirësuar punën e trupit gjykues në kryerjen e procesit të rivlerësimit, e cila do të vlerësohet në tërësinë e procesit të tij së bashku me rezultatet e hetimit administrativ.[...]”.

të pasurisë dhe të kriterit të aftësive profesionale. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit vlerësohen prej trupit gjykues haptazi të pabazuara.

**11.1.2.** Lidhur me pretendimin se *për kërkesat e tij në lidhje me procesin, si ajo për pezullimin e procedurës administrative deri në përfundimin e procesit gjyqësor pranë Gjykatës Administrative, për konfirmimin e dokumenteve për pagesën e tatimeve gjatë ushtrimit të avokatisë në vitet 1992-1997, Komisioni nuk ka kthyer përgjigje dhe as nuk e ka marrë në shqyrtim, në mungesë të theksuar angazhimi, nga aktet në dosjen gjyqësore, konstatohet dhe vlerësohet si vijon. Në datën 07.02.2024, me vendimin nr. {\*\*\*}, Komisioni ka vendosur mbylljen e hetimit administrativ kryesisht, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e tij, duke i kaluar barrën e provës për sa rezultuar, për të drejtën të njihet me provat e administruara në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, si dhe për të paraqitur shpjegime/prova shtesë brenda datës 16.02.2024. Me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, kërkesa e paraqitur prej subjektit në datën 11.02.2024, për shkak se deri në datën 13.02.2024 ishte me raport mjekësor për paaftësi në punë, që të shtyhej afati për paraqitje të provave me 10 ditë, pas datës 16.02.2024, është pranuar prej Komisionit duke e zgjatur afatin deri në datën 01.03.2024. Në datën 12.02.2024, subjekti i rivlerësimit është njohur me materialet e dosjes dhe në datën 23.02.2024 ka dërguar në rrugë elektronike shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit kryesisht të shoqëruara me dokumentacion. Në vijim, pasi është ftuar nga Komisioni në datën 06.03.2024 në seancën dëgjimore të caktuar për në datën 11.03.2024, në datën 7.03.2024 subjekti ka dërguar në rrugë elektronike (me e-mail) kërkesën për shtyrje të seancës dëgjimore për shkak të njoftimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor se në datën 13.03.2024, ora 11:00, ishte caktuar zhvillimi i seancës dëgjimore për fillimin e procedimit disiplinor ndaj tij, për mospranimin e së cilës është njoftuar nga Komisioni, po në rrugë elektronike. Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 11.03.2024, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar përjashtimin e trupit gjykues, me pretendimin për kryerje të disa shkeljeve të rënda procedurale ndaj procesit, konkretisht se nuk i është përgjigjur kërkesave: (i) për pezullimin e procedurës administrative deri në përfundimin e procesit gjyqësor të Gjykatës Administrative, për konfirmimin e dokumenteve të Bankës Shtetërore, për pagesën e tatimeve të subjektit të avokatisë në vitet 1992-1997; (ii) nuk ka vlerësuar provat e reja të paraqitura prej tij, madje ka vendosur barrën e provës në mënyrë të paarsyeshme për të dhëna të cilat janë dokumentuar që prej vitit 1992; (iii) lënien e një afati shumë të shkurtër përgatitjeje prej 3 ditësh në caktimin e seancës dëgjimore; (iv) nuk është pranuar kërkesa për shtyrjen e datës së seancës dëgjimore, për shkak se në datën 13.03.2024 do të zhvillohej seancë dëgjimore në KLGj. Kërkesa e subjektit për përjashtimin e trupit gjykues, të cilën subjekti e ka bazuar në nenin 30, paragrafi “g” i Kodit të Procedurave Administrative<sup>13</sup> dhe ku rezultojnë të parashtruara të njëjtat shkaqe si në ankim që sipas tij vinin/vënë në dyshim paanësinë dhe pavarësinë e trupit gjykues të Komisionit, është shqyrtuar nga një tjetër trupi gjykues i caktuar me short dhe është disponuar me vendimin nr. 742/3 prot., datë 11.03.2024, duke vendosur mospranimin e saj. Duke vlerësuar analizën në vendimin nr. 742/3 prot., datë 11.03.2024, të drejtë, të bazuar, të plotë dhe shteruese, trupi gjykues vlerëson se edhe në ankim, subjekti në*

---

<sup>13</sup> Neni 30 “Pengesat ligjore”, parashikon: “Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në rastet kur:[...] g) Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij, neni kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative në shqyrtim; [...]”.

asnjë rast nuk ka parashtruar shkaqe dhe rrethana konkrete në kuptim të parashikimeve të dispozitës mbi të cilën ka mbështetur kërkesën e tij, e cila përcakton në mënyrë shteruese rastet e dorëheqjeve të anëtarit të organit vendimmarrës në një procedurë administrative. Në mungesë të shkaqeve/rrethanave konkrete, të cilat do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri, trupi gjykues e vlerëson të papranueshme sjelljen e subjektit që katër vite pas fillimit të procesit të tij të rivlerësimit në dhjetor 2020, në datën 22.02.2024 t'i drejtohej gjykatës për konfirmim të dokumenteve të disponuara prej tij dhe, në të njëjtën ditë, me paraqitjen e parashtrimeve, të kërkonte pezullimin e procedurës në pritje të vendimit të gjykatës, që hipotetakisht mund të merrte kohë edhe përtej afatit të funksionimit të Komisionit. Për më tepër, Komisioni, edhe në mungesë të vendimit të pritshëm të gjykatës, në analizën financiare, ka përfshirë të gjithë të ardhurat nga avokatia, pavarësisht se për mandatpagesat bankare të disponuara prej subjektit, mbi të cilat pretendonte ligjshmërinë e të ardhurave, DRT-ja Vlorë ishte shprehur *se nuk mund të pranojë të vendosë në dosjen e tyre fizike pranë arshivës së DRT-së Vlorë, sepse janë dokumente të cilat duhet të vendoseshin në dispozicion që në momentin që janë kryer pagesat pranë bankave, dhe e ka të pamundur të shprehet lidhur me origjinalitetin e tyre*. Sa i përket vlerësimit të provave, që ka bërë Komisioni në interpretim dhe zbatim të kuadrit ligjor të zbatueshëm dhe jo sipas pritshmërisë të subjektit, ai konsiderohet se është në përmbushje të kompetencës dhe diskrecionit të organeve të rivlerësimit, dhe nuk mund të përbëjë shkak për të pretenduar anshmëri të anëtarëve të trupit gjykues dhe aq më pak për të kërkuar përjashtimin e trupit gjykues.

**11.1.3.** Lidhur me pretendimet për të dhëna të dokumentuara qysh prej vitit 1992, është vendosur barrë prove në mënyrë të paarsyeshme dhe se analiza financiare e ekspertit privat ka vënë në dukje se hetimi i Komisionit ka qenë i cekët dhe pa analizuar provat në mënyrë shteruese, trupi gjykues konstaton se barra e provës është vendosur për gjetje të rezultuara nga hetimi administrativ kryesisht, në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016<sup>14</sup>. Lidhur me analizën financiare të ekspertit privat A. M., të paraqitur si provë prej subjektit me parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, përpos se është hartuar bazuar në deklaratimet e subjektit e, si i tillë, është një dokument i njëanshëm, konstatohet se dhe sipas këtij akti subjekti rezulton me balancë negative në shumën (-) 2.924.219 lekë, rezultat i cili *dedukton* se edhe prej konsiderimit të gjithë pretendimeve të subjektit, ai dhe personat e lidhur sërish do të rezultonin me pamundësi financiare për krijimin me burime të ligjshme të pasurive dhe përbalimin e shpenzimeve të jetesës.

**11.1.4.** Lidhur me pretendimet për lënien e një afati shumë të shkurtër përgatitjeje prej 3 ditësh në caktimin e seancës dëgjimore dhe mospranim të kërkesës për shtyrjen e datës së seancës dëgjimore, për shkak se në datën 13.03.2024 do të zhvillohej seancë dëgjimore në KLGj, duke konstatuar se për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave Komisioni ka shtyrë afatin përtej 10 ditëve të kërkuara prej subjektit, se subjekti ka paraqitur prapësimet dhe dokumentacionin për të përmbysur barrën e provës në datën 23.02.2024 dhe seanca dëgjimore është zhvilluar në datën 11.03.2024, trupi gjykues e vlerëson haptazi të pabazuar pretendimin e subjektit *se është njoftuar për përgatitje për procesin me vetëm 3 ditë përpara seancës dëgjimore, që aq më tepër nuk mund të administrohen prova në favor të parimit të kontradiktoritetit*. Duke sjellë në

---

<sup>14</sup> [...] Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45, të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën. [...].

vëmendje se në kuptim të parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative, seanca dëgjimore i shërben subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar për sa shpjeguar e parashtruar në parashtrime, të cilat ai i kishte paraqitur bashkë me dokumentacion provues shumë përpara se të njoftohej për datën e seancës dëgjimore, trupi gjykues i gjen haptazi të pabazuara pretendimet e subjektit për pamundësi të sigurimit/administrimit të provave dhe pretendimin për cenim të parimit të kontradiktoritetit e vlerëson haptazi të pabazuar dhe si përpjekje të subjektit për të delegjitimuar procesin e tij të rivlerësimit. Për sa më sipëranalizuar, trupi gjykues vlerëson se parimet kushtetuese, konventore dhe ligjore të paanësisë dhe objektivitetit në gjykim nuk janë cenuar në asnjë rast prej Komisionit.

**11.2.** Lidhur me pretendimin për cenim të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, shkaqet e parashtruara prej subjektit dhe vlerësimi i trupit gjykues për to është si vijon.

**11.2.1.** Lidhur me pretendimin se *vetëm në vendimin e arsytuar është vënë në dijeni se Komisioni ka njohur të ardhurat nga avokatia për vitet 1992-1999, ndërkohë që ka ndryshuar të dhënat në disfavor të subjektit duke shtuar në mënyrë të shpërpjesëtuar shpenzimet jetike për këtë periudhë, pa i dhënë mundësi për të kundërshtuar këtë gjetje, për të paraqitur prova dhe fakte*, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon. Me raportin e rezultateve të hetimit administrativ kryesisht, për periudhën deri në datën 06.03.2000, subjektit nuk i janë njohur të ardhurat nga ushtrimi i profesionit të avokatisë për periudhën 1992-1999 dhe për këtë periudhë nuk i janë llogaritur shpenzime jetese. Në vendim, rezulton se janë njohur të ardhurat nga veprimtaria e avokatisë dhe në analizën financiare, pasqyruar në vendim, konstatohet se shpenzimet e jetesës për këtë periudhë janë përlllogaritur në masën 66% të të ardhurave. Kolegji, në përmbushje të kompetencës së njohur nga ligji nr. 84/2016, në jurisprudencën e tij<sup>15</sup> ka mbajtur qëndrim lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën për të cilën institucionet nuk ofrojnë të dhëna, në rastin konkret 1992-1999, duke orientuar edhe Komisionin për trajtimin e kësaj çështjeje. Konkretisht, në qëndrimin e mbajtur, Kolegji ka vlerësuar *66% e shpenzimeve në raport me të ardhurat nga punësimi para vitit 2000 do të merrte kuptim vetëm kur të trajtoheshin të ardhura mesatare të sektorit publik që shkojnë për afërsisht në vlerën rreth 800 USD në vit*, ndërsa në rastin e subjektit të rivlerësimit Hektor Sinanaj nuk rezulton të ekzistojnë komponentët e sipërpërmendur, ai nuk ka qenë nëpunës publik dhe të ardhurat e tij nga avokatia, të pranuar prej vetë Komisionit, janë ndjeshëm më të larta se niveli i të ardhurave mesatare të sektorit publik. Mungesa e një analize në vendimin objekt shqyrtimi, për metodologjinë e aplikuar për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës të subjektit dhe personave të lidhur për periudhën 1992-1999, vlera e lartë e rezultuar për to për shkak të llogaritjes mbi vlerën e lartë të të ardhurave, si dhe fakti se me këtë vlerë subjekti është njohur vetëm përmes vendimit të Komisionit, çojnë trupin gjykues në konkluzionin se Komisioni nuk ka e zbatuar në mënyrë të drejtë orientimin e Kolegjit për metodologjinë e përlllogaritjes së tyre, dhe se pretendimet e subjektit për cenim të parimit të kontradiktoritetit në këtë rast qëndrojnë. Duke theksuar se kjo çështje do të trajtohet gjerësisht në shkaqet e ankimit lidhur me themelin, trupi gjykues vlerëson se garantizmi i ofruar nga Kolegji, përmes përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës së kësaj periudhe në mënyrë të unifikuar si për magistratët, pavarësisht se subjekti nuk e gëzon këtë status gjatë kësaj periudhe, shëron

<sup>15</sup> Vendimi i Kolegjit nr. 15 (JR), datë 18.06.2021.

gabimin procedural të Komisionit e, për rrjedhojë, nuk gjen shkak për riçelje të hetimit gjyqësor, sikundër pretendon subjekti.

**11.2.2.** Lidhur me pretendimin se *Komisioni nuk i është përgjigjur asnjë sqarimi të dhënë lidhur me të ardhurat nga qiratë, duke vlerësuar në kundërshtim me provat dhe faktet se marrëdhënia e qirasë ka qenë mes individëve, brenda afateve ka vënë në dispozicion prova se qiramarrësit kanë qenë subjekte tatimore, Komisioni nuk është shprehur për këto prova, duke mos zhvilluar një hetim objektiv dhe të gjithanshëm, duke mos dhënë mundësi për të sqaruar me të dhëna të tjera, nëse nuk do të ishte bindur për sa ishte paraqitur*, trupi gjyqësor konstaton dhe vlerëson si vijon. Lidhur me të ardhurat nga qiratë, të deklaruara në deklaratën *vetting* në vlerën 8.522.000 lekë dhe 36.000 euro, në pyetësorë subjektit i janë adresuar pyetje prej Komisionit për të dhënë shpjegime dhe paraqitur dokumentacion për pagimin/shlyerjen e detyrimeve tatimore. Në raportin për rezultatet e hetimit administrativ, duke referuar në parashikimet e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nenit 8 “E ardhur e tatueshme”, sqarimeve në pikën 2.3.6 të udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, dhe analizuar se në kontratat e qirave, përgjithësisht verbale, vetëm në 3 vitet e fundit, të lidhura në prani të noterëve publikë, nuk përcaktohej se cila palë ka përgjegjësinë tatimore, nuk ishin lidhur sipas përcaktimeve ligjore të sipërcituara, nga hetimi nuk ka rezultuar të jenë shlyer detyrimet tatimore për të ardhurat e fituara nga qiratë<sup>16</sup> dhe as të jetë mbajtur tatim në burim nga asnjëra prej palëve, Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga qiraja. Në prapësimet e tij për rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, subjekti ka paraqitur deklarata noteriale të disa prej qiramarrësve, duke u shprehur se përmes tyre provohet se *ata kanë qenë subjekt përgjegjës i deklarimit tatimor për tatimin në burim të të ardhurave nga qiraja [...] deklarata të tilla janë plotësuar (në dijeninë tonë) nga subjektet qiramarrëse, çka i bën këto të ardhura nga qiraja të justifikueshme me pagesën e tatimeve*. Sa më sipër, përkundrejt detyrimit ligjor të subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave, pra, pagesën e detyrimeve tatimore, sjellja e tij për të përmbushur këtë detyrim përmes deklaratave noteriale, ku për më tepër konstatohet se në asnjë prej tyre shtetasit nuk deklarojnë për realizimin ose jo të përgjegjësisë së tyre tatimore dhe jo me dokumentacion ligjor, e bëjnë të haptazi të pabazuar pretendimin se ka provuar ligjshmërinë e të ardhurave nga qiratë. Në këtë situatë ligjore dhe faktike, në kuptim të parashikimeve të kuadrit ligjor të rivlerësimit, i cili parashikon kalimin e barrës së provës te subjekti i rivlerësimit *për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën* e gjetjeve të rezultuara, dështimi për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara nga qiratë, me pasojë dështimin për të provuar edhe ligjshmërinë e pasurive të deklaruara me këtë burim krijimi, mbetet pasojë e zgjedhjes së vetë subjektit për ushtrimin e të drejtave dhe zbatimin e detyrimeve të tij, dhe pretendimi i tij se *Komisioni nuk ka zhvilluar një hetim objektiv dhe të gjithanshëm, duke mos dhënë mundësi për të sqaruar me të dhëna të tjera, nëse nuk do të ishte bindur për sa ishte paraqitur*, përpos i pakuptimtë, vlerësohet haptazi i pabazuar.

**11.2.3.** Lidhur me pretendimin se *për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni është bazuar në një vlerësim të disa anëtarëve të KLGj-së, të cilin e ka bërë me dije në përfundim të hetimit administrativ, duke cenuar të drejtën për të kundërshtuar përbërjen e trupës së anëtarëve të KLGj-së, ku një prej anëtarëve ka mbajtur qëndrim hakmarrës për shkak të një çështje të gjykuar prej tij*, trupi gjyqësor sjell në vëmendje se, në kuptim të parashikimeve

<sup>16</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 08.03.2021, e DRT-së.

të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nuk ka asnjë detyrim të bëjë me dije të dhëna rreth raportit të përcjellë nga organi ndihmës, KLGj-ja, përpara vendimit për mbylljen e hetimit administrativ kryesisht. Për më tepër, kuadri ligjor i rivlerësimit nuk parashikon të drejtën e subjektit për të kundërshtuar përbërjen e trupës së KLGj-së, që harton raportin për vlerësimin e aftësive profesionale, si një dokument në ndihmë të organeve të rivlerësimit për kryerjen e procedurave të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit, në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm. Pavarësisht raportit të përcjellë prej KLGj-së, organet e rivlerësimit, Komisioni në këtë rast, në përmbushje të kompetencave të tyre, zhvillojnë një hetim të plotë e të gjithanshëm për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, duke administruar edhe dokumentacion tjetër, kryesisht apo si nevojë e shqyrtimit të denoncimeve nga publiku. Në rastin e subjektit të rivlerësimit Hektor Sinanaj, konstatohet se me raportin për rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, subjektit i ka kaluar barrë prove për një sërë çështjesh që kanë lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, gjetjet për të cilat e ngarkonin me përgjegjësi në kuptim të ligjit, ndërkohë që prej tij, shumica e tyre është lënë pa përgjigje. Sa më sipër, pretendimet e subjektit, edhe në këtë rast, vlerësohen haptazi të pabazuara.

**11.2.4.** Lidhur me pretendimin për cenim të së drejtës për një vendim të arsyetuar, subjekti fokuson se nuk i është dhënë përgjigje pretendimeve të tij për kërkesën për pezullimin e procesit të rivlerësimit dhe për marrjen e provave për vlerësimin e të ardhurave nga qiraja, dhe se për kriterin e aftësive profesionale prej Komisionit përdoren fjali stereotipe *se konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit* pa arsyetuar cilat janë këto problematika dhe pa cituar asnjë sqarim ndaj pretendimeve të subjektit të rivlerësimit. *Së pari*, sikundër analizuar më lart, kërkesa e subjektit për përjashtim të trupit gjykues, e cila paraqitej edhe për shkak të mospërgjigjes ndaj *kërkesës për pezullim të procesit të tij të rivlerësimit deri në përfundimin e procesit gjyqësor të Gjykatës Administrative, për konfirmimin e dokumenteve të Bankës Shtetërore për pagesën e tatimeve të subjektit të avokatisë në vitet 1992-1997 avokatisë*, është disponuar me vendimin nr. 742/3 prot., datë 11.03.2024, prej trupit gjykues të shortuar për shqyrtimin e saj, i cili ka analizuar plotësisht e në mënyrë shteruese mbi pabazueshmërinë e saj. Trupi gjykues i Kolegjit, duke konstatuar se me deklaratën *vetting* subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor lidhur me shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga ushtrimi i avokatisë, në mosplotësim të detyrimeve ligjore të buruara nga kuadri ligjor i rivlerësimit, si dhe qëndrimin e tij inaktiv gjatë periudhës 4-vjeçare të hetimit administrativ, për të ndërmarrë veprimet e duhura për të siguruar dhe paraqitur dokumentacionin e nevojshëm, e gjen të pakuptimtë paraqitjen e kërkesës për pezullim të procedurës, ndërkohë që Komisioni kishte disponuar me vendim për mbylljen e hetimit administrativ kryesisht. Në vijim, duke konstatuar edhe se subjekti pas paraqitjes në datën 05.01.2024 të një kërkesë me objekt *“Mbarim i statusit të magjistratit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes”*<sup>17</sup>, në datën 16.01.2024 ka paraqitur sërish kërkesë për revokimin e saj<sup>18</sup>, trupi gjykues vlerëson se kërkesat e subjektit duket të kenë synuar krijimin e ngjarjeve procedurale, që synojnë zgjatjen e procesit të tij të rivlerësimit. *Së dyti*, lidhur me të ardhurat nga qiraja, për të cilat me deklaratën *vetting* subjekti ka depozituar kontratat e qirave, provat e paraqitura prej tij për të provuar ligjshmërinë e tyre/shlyerjen e detyrimeve tatimore, si gjatë hetimit administrativ në përgjigje të

<sup>17</sup> Administruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 08.01.2024.

<sup>18</sup> Administruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 18.01.2024.

pyetësorëve, ashtu edhe në përgjigje të barrës së provës kaluar me raportin për rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, pasqyrohen në vendimin objekt shqyrtimi. Lidhur me deklaratat noteriale të disa shtetasve, paraqitur prej subjekti në përgjigje të barrës së provës, mosanalizimi dhe vlerësimi për to në vendimin objekt shqyrtimi nuk mund të pretendohet si cenim i të drejtës për një vendim të arsyetuar. Në jurisprudencën e tyre, organet e rivlerësimit kanë mbajtur një qëndrim të konsoliduar lidhur me vlerën e dobët provuese të këtyre akteve të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit e në favor të pretendimeve të subjekteve të rivlerësimit e, për rrjedhojë, ripërsëritja formale e këtij qëndrimi edhe pas 6 vjetësh jetësimi të procesit të rivlerësimit çmohet jorelevante. *Së treti*, lidhur me pretendimin se për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale përdoren fjali stereotipe me pretendimin se konstatohen problematika, pa arsyetuar cilat janë ato dhe pa cituar asnjë sqarim ndaj pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon. Në vendimin objekt shqyrtimi, për çështjet e shqyrtuara lidhur me rivlerësimin e aftësive profesionale, pasqyrohet analiza e Komisionit për mangësitë e evidentuara në vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit në raport me kuadrin ligjor të zbatueshëm dhe gjetjet e rezultuara lidhur me to. Për rastet për të cilat subjekti ka dhënë shpjegime në përgjigje të rezultateve të hetimit, pasi për disa çështje ai nuk ka dhënë shpjegime për gjetjet e rezultuara, në vendim, pasqyrohet qëndrimi i subjektit, vlerësimi i Komisionit për shpjegimet e dhëna dhe, mbi bazë të këtij vlerësimi, përfundimi i arritur se konstatohen problematika që kanë lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen haptazi të pabazuar pretendimin e subjektit për përdorim të “fjali stereotipe” prej Komisionit dhe për moscitim të pretendimeve të tij lidhur me rivlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vlerëson haptazi të pabazuar pretendimet e tjera për cenim të së drejtës për një vendim të arsyetuar.

**11.3.** Subjekti i rivlerësimit pretendoi për *cenim të respektimit të jetës private, në kuptim të parashikimeve të nenit 8 të KEDNj-së për respektim të jetës private dhe familjare*, pasi, sipas tij, vendimmarrja me shkarkimin nga detyra e konkretisht vlerësimi për kriterin e pasurisë, kanë cenuar rëndë personalitetin e tij, madje duke përbërë shkak që subjekte mediatike të përflasin në mënyrë të padrejtë në lidhje me figurën dhe personalitetin e tij. Duke sjellë në pah se veprimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me konfliktin e interesit, për të cilin do të analizohet në detaj në vijim të këtij vendimi, kanë gjetur pasqyrim në media përpara se Komisioni të shpallte vendimin e tij, trupi gjykues sjell në vëmendje se publikimi i vendimeve në faqen zyrtare të Komisionit e, për rrjedhojë, marrja dijani lidhur me çështjet e trajtuara nuk mund të pretendohet për cenim të parimit të respektimit të jetës private. Subjektet e rivlerësimit, që i janë nënshtruar me vullnetin e tyre të plotë procesit të rivlerësimit, kanë qenë në dijani se ky proces zhvillohet në transparencë të plotë bazuar në kuadrin kushtetues dhe ligjor të rivlerësimit. Për pasojë, edhe ky pretendim i subjektit, gjithashtu, vlerësohet haptazi i pabazuar.

12. Në përmbledhje të sa më sipëranalizuar, në funksion të pretendimeve të subjektit me natyrë procedurale, trupi gjykues vëren se procesi i kryer për subjektin në Komision është i rregullt dhe në përputhje me garancitë kushtetuese, ligjore dhe standardet ndërkombëtare të njohura dhe pretendimet e subjektit lidhur me to janë të pabazuara.

### ***C. Vlerësimi për shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë***

#### ***Lidhur me shpenzimet e jetesës për periudhën 1992-2003***

13. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi përllogaritjen prej Komisionit të shpenzimeve të jetesës për periudhën 1992-2003, në vlerën prej 10.993.980 lekësh, si hipotetike, tërësisht të pabazuar, e të vendosur pas dhënies së vendimit të shkarkimit. Për këtë shkak ankimi, përpos pretendimit se është privuar nga e drejta e mbrojtjes për të dhënë shpjegime lidhur me to në Komision, për të cilin u analizua gjerësisht më lart, subjekti parashtroi se fakti që ka pasur të ardhura të larta, jo domosdoshmërisht sjell konkluzionin që edhe shpenzimet kanë qenë të larta, kjo për arsye se synimi i familjes ka qenë krijimi i kursimeve për të investuar në zhvillimin e pasurisë së paluajtshme në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, sikundër dëshmohet se ka ndodhur duke shtuar dy kate ndërtime në këtë pasuri. Sipas tij, për periudhën 1992-2003, shpenzimet jetike për pesë persona duhet të llogariten bazuar në të dhënat e INSTAT-it<sup>19</sup>, duhet të përkohet me vlerën 4.325.120 lekë dhe jo 10.993.980 lekë, siç e ka vlerësuar në mënyrë të qëllimshme Komisioni.
14. Trupi gjykues, nga analiza financiare e pasqyruar në vendimin objekt shqyrtimi, lidhur me shpenzimet e jetesës së periudhës 1992-2003, përllogaritja e të cilave kontestohet prej subjektit, e që kryesisht sjell pasojë në burimet financiare për krijimin e pasurisë *godinë 3-katëshe (kati i parë me destinacion zyra dhe 2 kate banimi)*, ndërtuar nga fundi i vitit 1992 deri në vitin 2006, konstaton se përllogaritja e tyre për periudhën 1992-2002 rezulton në shumën 10.993.980 lekë, ku për periudhën 1992-1999 shuma 9.570.000 lekë është përllogaritur në masën 66% të të ardhurave dhe për periudhën 2000-2002 shuma 1.423.980 lekë është përllogaritur sipas të dhënave të INSTAT-it. Për këtë përllogaritje të shpenzimeve të jetesës, kryer nga Komisioni, në raport me pretendimet e subjektit, si dhe nga shqyrtimi i akteve në dosjen gjyqësore, trupi gjykues vlerëson si vijon.

14.1. *Së pari*, Kolegji në jurisprudencën e tij ka qëndrim të konsoliduar për përllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën nga viti 2000, për të cilën ekzistojnë vlera të përcaktuara nga organi shtetëror i ngarkuar posaçërisht me matjen e nivelit të jetesës në vend, të cilat janë përcjellë në Kolegj nga ILDKPKI-ja, ku të dhënat e përcaktuara burojnë nga publikimet zyrtare të INSTAT-it. Në këtë kontekst, për përllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën nga viti 2000, si në rezultatet e hetimit administrativ, ashtu edhe në vendim, Komisioni i është referuar pikërisht informacionit të ILDKPKI-së, ku të dhënat për vitet korrente nuk ndërvaren apo kushtëzohen nga të ardhurat e subjektit. Për më tepër, në raportin për rezultatet e hetimit administrativ, përmes analizës financiare pjesë e tij, subjekti është njohur me vlerën e shpenzimeve të jetesës për vitet 2000-2003, e njëjtë si në vendim, dhe nuk e ka kundërshtuar atë. Për sa më sipër, pretendimet e subjektit, sa i përket përllogaritjes së shpenzimeve të jetesës për vitet 2000-2003, vlerësohen prej trupit gjykues haptazi të pabazuara.

14.2. *Së dyti*, lidhur me identifikimin e mundësive financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurisë *godinë 3-katëshe*, në raportin për rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka pasqyruar analizën financiare për periudhën 06.03.2000-2006, duke mospërfshirë të ardhurat e subjektit të deklaruara/pretenduara nga avokatia për periudhën 1992-1999, e duke mospasqyruar as shpenzime jetese për këtë periudhë. Në vendim, Komisioni ka vlerësuar të përfshijë edhe të ardhurat e subjektit nga ushtrimi i avokatisë, duke arsyetuar për vlerën e tyre: [...] Komisioni do të përfshijë në analizën financiare të ardhura neto të llogaritura me marzh fitimi 90% për qarkullimin minimal prej 2.000.000 lekësh në vit, për periudhën 1992-1999, duke u mbështetur në praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit, mbi të

<sup>19</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 21.02.2019.

*ardhurat nga ushtrimi i veprimtarisë së avokatisë. Komisioni çmon se e ardhura totale që duhet të përfshihet në analizën financiare nga ushtrimi i veprimtarisë së avokatisë prej subjektit është 13.500.000 lekë [...]. Me përfshirjen e këtyre të ardhurave, në analizën financiare të periudhës 1992-1999, shpenzimet e jetesës janë llogaritur në vlerën 10.993.980 lekë.*

**14.2.1.** Kolegji në jurisprudencën e tij<sup>20</sup> ka orientuar Komisionin për metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve të jetesës para vitit 2000, për të cilën institucionet përgjegjëse si INSTAT-i nuk kanë të dhëna statistikore. Konkretisht, nga një vështrim i thjeshtë i të dhënave nga burime të hapura, për pagat në vend në këtë periudhë, ka rezultuar se raporti i pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve me ato të funksionarëve të tjerë të sektorit publik, qëndronte përafërsisht në raportin rreth 30% më të larta. Parë këtë raport, krahasimisht me informacionin e Bankës së Shqipërisë të vitit 1995, Kolegji ka vlerësuar se në rastin e analizës financiare në të cilën figurojnë të ardhura të siguruara nga puna e gjyqtarëve apo prokurorëve, shpenzimet e jetesës duhet të llogariten në masën 30% të të ardhurave, i cili përafron me masën e shpenzimeve për jetesë në raportin 66% të të ardhurave, që i përkasin pagave mesatare të të gjithë sistemit të pagave. Në këtë qëndrim, Kolegji, gjithashtu, ka vlerësuar: *“Organet e rivlerësimit sigurisht që duhet të kryejnë një analizë logjike e të arsyeshme për përlogaritjen e këtyre shpenzimeve në raste në të cilat ndërthuren elemente të tjera, duke mbajtur në çdo rast në konsideratë se masa prej 66% e shpenzimeve në raport me të ardhurat nga punësimi para vitit 2000, do të merrte kuptim vetëm kur të trajtoheshin të ardhura mesatare të sektorit publik që shkojnë përafërsisht në vlerën rreth 800 USD në vit, sipas referencës së Bankës së Shqipërisë, dhe duke e vlerësuar këtë orientim në drejtim të përcaktimit të një analize logjike dhe jo si një referim ligjor i detyrueshëm për zbatim”*. Në këtë qëndrim, orientuar prej arsyetimit ligjor se standardi për shpenzimet e jetesës duhet të jetë i njëjtë për shtetasit dhe subjektet e rivlerësimit për sa kohë që nuk rezultojnë të dhëna zyrtare që do të përcaktonin ndryshe, Kolegji, gjithashtu, shprehet se: *“Individët që fitojnë më shumë të ardhura, duke ruajtur të njëjtin standard për vlerën e shpenzimeve të llogaritura, duhet të kenë potencialisht më shumë mundësi kursimi”*. Referuar të dhënave nga aktet në dosjen gjyqësore, trupi gjykues vlerëson se në rastin e subjektit të rivlerësimit Hektor Sinanaj, për shpenzimet e jetesës së periudhës 1992-1999, Komisioni nuk ka analizuar e, për pasojë, as ka konkluduar në përputhje me qëndrimin e Kolegjit si më lartcituat, konkretisht për sa vijon.

**14.2.2.** Subjekti i rivlerësimit Hektor Sinanaj, me deklaratën *vetting*, si burim krijimi të pasurisë *godinë 3-katëshe* deklaroi kursime familjare të krijuara edhe nga të ardhurat nga puna si avokat dhe se *gjatë punës si avokat kam bërë edhe shkëmbim valute nga ku kam nxjerrë përfitime në të ardhura në treg të lirë*. Të ardhurat nga veprimtaria e avokatisë, që bazuar në ligjin e kohës ishte fitimprurëse<sup>21</sup>, deklarohen prej subjektit edhe në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, për secilin prej viteve të periudhës 1992-1999<sup>22</sup>. Me deklaratën *vetting*, subjekti ka përcjellë kopje të vërtetimit nga Dega e Sigurimeve Shoqërore Vlorë, nëpërmjet të cilit

<sup>20</sup> Vendimi nr. 15 (JR), datë 18.06.2021, që i përket subjektit K. S.

<sup>21</sup> Ligji nr. 7512, datë 10.08.1991, “Për sanksionimin e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, i cili në nenin 6 parashikonte: “Personat fizikë a juridikë private, vendas a të huaj, që ushtrojnë veprimtari sipas këtij ligji, i caktojnë vetë çmimet dhe tarifatat e prodhimeve e të shërbimeve, në bazë të kërkesës e të ofertës”.

<sup>22</sup> Subjekti deklaroi vlerat si vijon: viti 1992, 1.000.000 lekë; viti 1993, 1.200.000 lekë; viti 1994, 1.500.000 lekë; viti 1995, 2.000.000 lekë; viti 1996, 2.400.000 lekë; viti 1997, 500.000 lekë; viti 1998, 1.800.000 lekë; viti 1999, 3.400.000 lekë.

konfirmohet se ka kryer pagesa për kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhën 1992-2000, si dhe kopje të dokumentacionit për pagesën ndaj tatim-taksave për këtë aktivitet në këtë periudhë, ku prej institucioneve konfirmohen pagesat për shlyerjen e detyrimeve tatimore prej tij në vitet 1998-1999. Sipas qëndrimit të mbajtur prej Komisionit, në vendim, subjekti rezultoi të ketë përfituar të ardhura vjetore në një vlerë më të lartë se 800 USD<sup>23</sup>, madje edhe më të lartë se të ardhurat e magjistratit për këtë periudhë, logjikshëm shpenzimet e jetesës së tij duhet të llogariten sikundër ato të magjistratëve, pra, në masën 30% të të ardhurave. Për sa më sipër, aplikimi i raportit prej 66% për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës në raport me të ardhurat do të ishte një trajtim i pabarabartë, përkundrajt metodologjisë të aplikuar për subjekte të tjerë të rivlerësimit.

15. Sa më sipër, trupi gjykues gjen të bazuar pretendimin e subjektit për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës nga Komisioni vetëm për periudhën 1992-1999. Në konsideratë të qëndrimit orientues të Kolegjit, trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, vlerësoi të llogarisë shpenzimet e jetesës në masën 30% të të ardhurave për periudhën 1992-1999 dhe, sipas këtij korrektimi në analizën financiare, shpenzimet e subjektit për periudhën 1992-2002 u reduktuan në vlerën prej 5.773.980 lekësh, në raport me vlerën prej 10.993.980 lekësh, të vlerësuar prej Komisionit.

#### ***Lidhur me të ardhurat nga emigracioni në Greqi***

16. Në deklaratën *vetting*, për një prej pasurive të deklaruara *shtëpi banimi me sipërfaqe trualli 162 m<sup>2</sup> në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë*, subjekti deklaroi shpenzime për rikonstrukcion në periudhën 04.12.1992 deri në dhjetor 2004, të kryera me të ardhura nga puna përpara datës 04.12.1992, duke përfshirë në to të ardhura nga puna në Greqi, kryesisht punë krahu, në shumën 1.000.000 dhrahmi, të konvertuara në 500.000 lekë. Subjekti deklaroi *se gusht 1991 ka shkuar emigrant në Greqi, me vizë nga Ministria e Shëndetësisë për vizitë mjekësore te kunati R. R., kthyer në nëntor 1991, hyrë përsëri në fund të nëntorit 1991, kthim në mars 1992. Në Greqi kam punuar në punë të ndryshme, kryesisht punë krahu e dizenjo në qytetin Nafpatko e Itea, banuar në banesë me qira tek sahati i qytetit dhe në Itea Itea tek një banesë ish-shkollë. Emri i pronarit në Nafpatko, XH. C. “{\*\*\*}” punuar punë dizenjo e transport mallra, po ashtu te pronar K. S. SH. Në Itea mbledhje ullinj. Në formularin “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre” të deklaratës *vetting*, subjekti referon në deklarime të bëra në deklaratën e pasurisë së vitit 2004, lidhur me pasuritë e krijuara deri në këtë vit të deklaratimit, dhe burimet për to, ku përfshin edhe *punuar 7 muaj emigrant në Greqi*, dhe në kolonën përkatëse deklaroi si shumë të të ardhurave *neto* 16.400.000 lekë dhe 1.200.000 dhrahmi.*
17. Komisioni ka vlerësuar të mos i përfshijë në analizën financiare të ardhurat nga emigracioni, duke çmuar se subjekti *nuk përcolli prova shteruese për provueshmërinë e vlerës së përfituar në këtë periudhë dhe mbi ligjshmërinë e tyre*.
18. Subjekti pretendon se është i pabazuar vlerësimi i Komisionit për të mospranuar të ardhurat nga emigracioni në Greqi në vitin 1991-1992, të cilat janë të pamundura të vërtetohen me

---

<sup>23</sup> Referuar për llogaritjen së kryer nga Komisioni për të ardhurat e përfituara nga avokatia, rezultoi se subjekti ka përfituar të ardhura neto vjetore në shumën 1.800.000 lekë (qarkullimi minimal 2.000.000 lekë\* marzhin e fitimit 90%)

dokumentacion provues për shkak të kohës së largët. Subjekti pretendon se në këtë periudhë ka përfituar të ardhura në shumën 1.000.000 dhrahmi të konvertuara në shumën 500.000 lekë, nga punë të ndryshme, deklaratimet e bëra në deklaratën *vetting* lidhur me to dhe, sipas tij, Komisioni duhet të vlerësonte një sërë provash, si deklaratata nga shtetas të tjerë që kanë punuar në Greqi në të njëjtën kohë me të si dhe fotografi të asaj kohe.

19. Nga aktet në fashikull, rezulton se: (i) në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, si burim krijimi për investime në dy pasuri të paluajtshme dhe për krijimin e gjendjes *cash*, subjekti deklaroi edhe të ardhura nga puna 7-mujore si emigrant në Greqi në vitin 1992, pa deklaruar shumën e këtyre të ardhurave, për më tepër nuk deklaroi as totalin e shumës së investuar; (ii) në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se [...] *sapo u ktheva nga Greqia kam paguar për rikonstrukcionin e banesës së vjetër te lagja "{\*\*\*}"*, shumën 100.000 lekë për firmën "{\*\*\*}" (G. B.) nëpërmjet BKT-së Vlorë dhe pagesa për godinën firmës ndërtimore "{\*\*\*}" në shumën 100.000 lekë në llogari për kontratën e ndërtimit. Këto pagesa tregojnë faktin se kam punuar erdha nga Greqia me 400 mijë dhrahmi të kursyera kam komunikuar me dy bashkë emigrantë që kanë punuar bashkë V. dhe K. T. dhe motrën e tyre M., për të kërkuar deklaratë noteriale nga ish-pronarët, i janë shprehur se janë paraqitur tek një avokat i tyre, i cili nuk pranoi të jepte një deklaratë të tillë pasi kishim punuar pa siguracion dhe kishim sanksione. U kam rekomanduar dhe pres të më dërgojnë një deklaratë personale por që vonon për shkak të largësisë [...]. Subjekti ka përcjellë disa fotografi për të cilat deklaroi se janë bërë në shtetin grek gjatë kohës së qëndrimit të tij atje dhe, në vijim, ka paraqitur deklaratë të thjeshtë dore të shtetasve V. T., K. T. dhe M. T.
20. Sa më sipër, lidhur me të ardhurat nga emigracioni në Greqi, të cilat subjekti i deklaroi në deklaratën *vetting* të kenë qenë në vlerën 1.200.000 dhrahmi, në ankim i pretendon në vlerën 1.000.000 dhrahmi, si të fituara gjatë punësimit prej 7 muajsh në këtë vend, në vitet 1991-1992, për të cilat në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 nuk ka deklaruar vlerë, trupi gjykues ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë qoftë punësimin e plotë apo të pjesshëm, ekzistencën e të ardhurave në ndonjë formë apo edhe qëndrimin në Greqi. Në këto kushte, diskutimi për mospagimin e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, në kuptim të standardit të së ardhurës së ligjshme, sipas legjislacionit të rivlerësimit, fakt që deklarohet edhe prej vetë subjektit, vlerësohet si një element dytësor i mungesës së provueshmërisë dhe konsiderimit të këtyre të ardhurave. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për përfshirje në analizën financiare të të ardhurave nga emigracioni në Greqi vlerësohen prej trupit gjykues të pabazuara.

### ***Lidhur me kursimet e krijuara prej vitit 1983***

21. Në deklaratën *vetting*, në formularin "*Angazhime dhe veprimtari private/dhe ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre*", subjekti deklaroi të ardhura nga paga si i punësuar në Ndërmarrjen e Shpendëve Vlorë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë si përmbarues e sekretar gjyqësor, avokat në Kolegjin e Avokatëve Vlorë deri në vitin 1992 e, më pas, avokat i licencuar. Subjekti vijon deklarinimin se sipas vërtetimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe të DRSSH-së Vlorë nuk janë të pasqyruara këto vite pune, por prej tij disponohen dokumente për punësimin si sekretar gjyqësor, përmbarues gjyqësor me pagë 520 lekë dhe si avokat në Kolegjin e Avokatëve me pagë mujore dhe bonuse 1.000 lekë në muaj. Gjithashtu, këto të ardhura deklarohen si burim krijimi për tri pasuri të deklaruara, me periudhat përkatëse

të punësimit: 29.06.1983-28.08.1984, në Ndërmarrjen e Shpendëve Vlorë; 28.08.1984-16.03.1988, sekretar gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë; deri në datën 31.10.1990 përmbartes gjyqësor, e në këtë datë avokat në Kolegjin e Avokatëve Vlorë deri në gusht 1991, që ka shkuar emigrant në Greqi.

22. Komisioni këto të ardhura të deklaruara prej subjektit, që i përkasin periudhës përpara vitit 1990, nuk i ka përfshirë as në analizën financiare të hartuar në raportin për rezultatet e hetimit administrativ, duke u shprehur se nisur nga praktika e tij dhe e Kolegjit, aftësia për kursim gjatë kësaj periudhe nuk ka qenë e mundur vetëm me të ardhurat nga pagat. Në prapësimet e tij, subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur pretendime lidhur me këtë vlerësim të Komisionit e, gjithashtu, në raportin e ekspertit kontabël dhe në analizën financiare të përpiluar të dorëzuar si provë me prapësimet nuk pasqyrohen kursime të periudhës përpara vitit 1990, për më tepër të ardhurat e subjektit përlllogariten prej vitit 1992.
23. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se qëndrimi i Komisionit për të mos marrë në konsideratë këto të ardhura është i pabazuar. Sipas tij, argumenti se në këtë periudhë nuk mund të krijoheshin kursime është i gabuar, pasi bazohet në raste të përgjithshme, por në rastin e tij, deri në vitin 1991, para martesë, pagën e kursente dhe e kishte në bankë, sepse në familjen e tij ishin të punësuar të gjithë, babai, nëna, motrat dhe vëllezërit. Sipas subjektit, pavarësisht se kursimet e asaj kohe nuk mund të krahasohen me situatën e sotme ekonomike, ato kanë shërbyer në fillim të viteve 1990 për të ndërtuar shtëpi dhe ambiente zyresh për dhënie me qira.
24. Trupi gjykues, *së pari*, konstaton se në deklaratën e vitit 2003, për pasuritë e deklaruara, si burim krijimi subjekti deklaron vetëm të ardhurat nga emigracioni në Greqi, nga puna e tij 10-vjeçare si avokat (duke filluar nga viti 1992), si dhe nga puna si gjyqtar. Për rrjedhojë, vetë deklarimi i subjektit në deklaratën e tij të parë të pasurisë, e cila mund të përdoret si provë në këtë proces, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, e bën të pabazuar pretendimin e tij gjatë procesit të rivlerësimit për kursime të krijuara nga të ardhurat nga paga prej vitit 1983 e për përdorimin e tyre si burim për krijimin e pasurive. *Së dyti*, lidhur me kursimet e pretenduara të krijuara prej vitit 1983, të cilat, sipas deklaratimit të subjektit, në fillim të viteve 1990 kanë shërbyer për ndërtimin e shtëpisë dhe të zyrave, për vete dhe për dhënie me qira, trupi gjykues konfirmon qëndrimin e mbajtur nga Komisioni se ato nuk mund të konsiderohen se janë krijuar dhe kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive. Në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit në jurisprudencën e tij, aftësia për kursim gjatë kësaj periudhe nuk ka qenë e mundur vetëm me të ardhurat nga pagat për shkak të inflacionit të lartë të asaj periudhe. Për sa më sipër, trupi gjykues i vlerëson pretendimet e subjektit të pabazuara.

***Lidhur me të ardhurat nga marrëdhëniet e qirave për ambientet zyra në godinën trekatëshe, në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë***

25. Në deklaratën *vetting*, subjekti deklaron të ardhura nga dhënia me qira e ambienteve të pasurive të paluajtshme 1, 2, 3 dhe 4 në periudhën 2004-2016, sipas kontratave të qirave, në shumën 8.522.000 lekë dhe 36.000 euro (euro viti 2010-2013 dhe: “*Administrim nga bashkëshortja dhe dhënie me qira të ambienteve të pasurisë 3 dhe 4*”, [...] *Kontratat e qirasë së ambienteve tre*

---

<sup>24</sup>Në deklaratën *vetting*, subjekti me nr. {\*\*\*} deklaron: “Pasuria nr. {\*\*\*}; {\*\*\*}, z.k. {\*\*\*}, sipërfaqe 150 m<sup>2</sup> godinë njëkatëshe, rikonstruktuar me leje ndërtimi nr. {\*\*\*}, datë 13.07.2001 dhe nr. {\*\*\*}, datë 15.05.2001, sheshit ndërtimit dhënë nga KRRT Bashkia Vlorë me destinacion banesë 2 kate plus zyra në katin e parë.

*vitet e fundit pas daljes së VKM-së janë bërë noteriale, e futur në sistem, për efekt të tatimit në burim mbi të ardhurat nga qiraja, që sipas ligjit paguhen nga qiramarrësi, ndërsa qiradhënësi e llogarit paraprakisht në çmimin e kontratës”.*

26. Komisioni në raportin për rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe sqarimeve në pikën 2.3.6 të Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, duke analizuar se, në rastin e subjektit, kontratat e qirave përgjithësisht ishin verbale, deklaruar edhe prej vetë atij në deklaratën *vetting*, vetëm në 3 vitet e fundit ato janë lidhur në prani të noterëve publikë, në to nuk parashikohet se cila palë ka përgjegjësinë tatimore se nuk ishin lidhur sipas parashikimeve ligjore sipërcituar dhe se nga hetimi nuk rezultoi të jenë shlyer detyrimet tatimore për të ardhura të fituara nga qiratë dhe as të jetë mbajtur tatimi në burim nga njëra prej palëve, nuk i ka përfshirë të ardhurat nga qiraja në analizën financiare. Për rrjedhojë, në raportin për rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, nga analiza financiare për investimet në periudhën 2000-2006 në objektin godinë 3-katëshe në lagjen “{\*\*\*}”, në Vlorë, edhe për shkak të mospërfshirjes së të ardhurave nga qiraja, subjekti ka rezultuar me pamundësi financiare për të gjithë vlerën totale të deklaruar prej (-) 10.258.300 lekësh, ndërsa nga analiza financiare për periudhën 2003-2016, subjekti ka rezultuar me pamundësi financiare në vlerën (-) 26.527.843 lekë. Lidhur me shpjegimet dhe provat e paraqitura prej subjektit në përgjigje të barrës së provës së kaluar për pamundësinë financiare sipërcituar, Komisioni ka vlerësuar se ai nuk ka arritur të përmbysë barrën e provës lidhur me të ardhurat nga qiratë, duke konkluduar për periudhën 2003-2016, për pamundësi financiare në të njëjtën vlerë të subjektit dhe personave të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme kryerjen e shpenzimeve jetike dhe kryerjen e investimeve
27. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni në mënyrë abuzive nuk i ka njohur të ardhurat nga qiraja, me argumentet se: (i) marrëdhënia e qirasë është deklaruar në çdo deklaram periodik të pasurisë dhe është faktuar me kontrata qiraje të thjeshta dhe noteriale kur janë bërë ndryshimet ligjore për lidhjen e kontratave noteriale për qiratë; (ii) ka depozituar prova që faktojnë se qiramarrësit janë subjekte të regjistruara në organet tatimore, kontratat e qirasë të nënshkruara çdo vit dhe deklaratat noteriale të secilit prej qiramarrësve; (iii) referuar qëndrimit të Kolegjit<sup>25</sup>, lidhur me tatimin në burim, ka qenë detyrimi i qiramarrësit për llogaritjen dhe pagimin e detyrimit mbi të ardhurat personale nga qiradhënia duke pasur të qartë vlerën e qirasë, dhe provohet se qiradhënësi ka përfitur vlerën *neto* të qirasë të përcaktuar në kontratat e qirasë; (iv) referuar legjislacionit tatimor në periudhën që ka ekzistuar marrëdhënia e qirasë, detyrimin për pagesën e tatimit në burim e ka pasur subjekti qiramarrës, për shkak se ka qenë subjekt i regjistruar në organet tatimore, dhe ka rezultuar se pikërisht në periudhën e marrëdhënies së qirasë kanë paguar tatimin në burim; (v) në kushtet që Komisioni nuk ka pranuar provat e paraqitura prej tij që faktojnë se qiramarrësit kanë qenë subjekte tatimore, dhe

---

*Regjistruar si karabina në ZVRPP Vlorë me nr. {\*\*\*}, datë 29.10.2004, z.k. {\*\*\*}, vazhduar punimet deri në mars 2006 [...]. Pas marrjes së lejes së rikonstruksionit, në katin e parë (mbi katin përdhe) nga kursimet familjare, si dhe me kredi bankare nga BKT, kam përshtatur gjithsej 9 zyra, të cilat i ka dhënë me qira bashkëshortja me kontrata të rregullta me qiramarrësit. Më pas kati përdhe është përshtatur si kopsht fëmijësh në administrim nga bashkëshortja [...]”, me nr. {\*\*\*} deklaruar “Pasuria nr. {\*\*\*}, vol.{\*\*\*}, fq. {\*\*\*}, njësi 60 m<sup>2</sup> dhe nr. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, fq. {\*\*\*}, i truallit të njësisë, me certifikatat përkatëse të pronësisë lëshuar datë 08.09.2006. Mbi katin ekzistues, legalizuar shtesë kati me nr. pas.{\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, fq.{\*\*\*}, lëshuar certifikata e pronësisë datë 04.01.2011 [...].Në katin e I-rë dhe të II-të janë bashkuar ambientet e pasurisë 3 dhe pasurisë 4”.*

<sup>25</sup> Subjekti referon vendimin e Kolegjit nr. 14 (JR), datë 15.06.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit I. B.

që nuk mund të parashikohej konkluzioni i Komisionit për të quajtur qiramarrësit individë, është marrë informacion nga DRT-ja Vlorë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.07.2024, për disa nga subjektet qiramarrës, të cilët rezultojnë se kanë paguar tatimin në burim për periudhën e cituar në kërkesë, nga mund të konkludohet se kjo pagesë ka qenë vetëm për efekt të kontratës së qirasë që kanë pasur me qiradhënësen L. S. (bashkëshortja).

28. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të akteve në dosjen gjyqësore, por edhe në këndvështrim të shkresës së DRT-së Vlorë të paraqitur prej subjektit me ankimin, e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos i njohur të ardhurat nga marrëdhëniet e qirave, të deklaruara në deklaratën *vetting* për periudhën 2004-2016 në shumën 8.522.000 lekë dhe 36.000 euro, si burim të krijimit të pasurive, dhe vlerëson se subjekti ka dështuar të provojë ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, në kuptim të parashikimeve kushtetuese e ligjore. Në vijim analiza e trupit gjykues.

28.1. *Së pari*, subjekti nuk ka arritur të provojë krijimin e të ardhurave nga qiraja në vlerën e deklaruar, qoftë për shkak të paraqitjes së kontratave në formën e një shkrese të thjeshtë, deri në vitin 2015, por edhe të mungesës së çdo dokumentacioni financiar që do të mund të provonte përftimin e tyre sipas deklarimeve. Konkretisht, në përgjigje të pyetjeve të pyetësorit standard<sup>26</sup>, subjekti deklaroi se nga viti 2000 ka përfituar të ardhura nga dhënia me qira e ambienteve të pronës së ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, në Vlorë, të cilën e ka *rikonstruktuar* në objekt tre kate me qëllim biznesi dhe banimi, sipas lejes së ndërtimit nr. {\*\*\*}, datë 13.07.2001 dhe nr. {\*\*\*}, datë 15.05.2001, punime të pezulluara për periudhën 2001-2003, sipas Vendimit të Bashkisë Vlorë<sup>27</sup>, për shkak të konfliktit gjyqësor<sup>28</sup>, të rifilluara në mars të vitit 2004, e regjistruar si karabina në ZVRPP-në Vlorë me nr. {\*\*\*}, datë 29.10.2004, z.k. {\*\*\*}<sup>29</sup>, sipas kërkesës së tij *për të paradhënë ambiente dhe zyra me qira, që sipas ligjit lejoheshin edhe para përfundimit plotësisht të godinës*. Gjithashtu, në këtë pyetësor, ndër të tjera, subjekti deklaroi të ardhura: (i) nga individë/avokatë që kanë ndërruar jetë, e në pamundësi për të provuar në mënyrë shkresore marrëdhënien e qirasë me ta, ka përcjellë deklarata të personave/asistentë të tyre; (ii) nga shfrytëzimi i ambienteve për “bar-bilardo” nga i vëllai; (iii) nga qiratë e ambienteve zyrë ku qiramarrësit pasqyrohen si individë, sikundër përcaktohen këta të fundit edhe në kontratat e thjeshta të qirave (në ato që janë përcjellë prej subjektit). Gjithashtu, subjekti deklaroi se përveç njërit prej qiramarrësve, i cili vetëm në disa raste ka kryer pagesat e qirasë përmes bankës, qiramarrësit e tjerë i kanë likuiduar pagesat në *cash*, në mungesë të *vullnetit të tyre për t’i paguar me bankë*, pavarësisht kërkesës nga ana e tyre si qiradhënësit për t’i paguar me bankë. Për më tepër, në situatën kur vetë subjekti deklaroi se punimet në objekt

<sup>26</sup> Pyetja nr. 6 “*Që kur keni filluar detyrën deri sot, a keni marrë ndonjë vlerë qiraje apo të ardhura të tjera? Lutemi përcaktoni datat, shumat dhe paraqisni prova, me të cilat të vërtetohen deklaratimet tuaja. Lutemi specifikoni nëse janë paguar tatimet dhe nga kush*”.

<sup>27</sup> Nr. {\*\*\*} prot., datë 08.01.2002, lëshuar nga Seksioni i Urbanistikës, përgjegjës Ark. S. C., Bashkia Vlorë.

<sup>28</sup> Subjekti shpjegon se me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 15.10.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është vendosur ligjshmëria e lejes së ndërtimit dhe rrëzimi padisë ngritur ndaj Hektor Sinanaj. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë nr. {\*\*\*}, datë 25.02.2002, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.05.2004, të Gjykatës së Lartë.

<sup>29</sup> Subjekti shpjegon se sipas ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, “Për Urbanistikën”, nga Bashkia Vlorë, Drejtoria e Urbanistikës është ushtruar akt kontrolli, duke vërtetuar përfundimin e karabinasë për të gjithë objektin e ndërtimit. Aktet e Bashkisë janë dërguar pranë ZVRPP-së Vlorë (sot ASHK), e cila ka lëshuar certifikatën e pronësisë, nr. {\*\*\*}, datë 29.10.2004, me të cilën është operuar për dhënie e ambienteve me qira.

kanë vijuar deri në vitin 2006, duket e vështirë të besohet se edhe për vitet 2004-2006 ambientet të tij janë shfrytëzuar e dhënë me qira duke siguruar të ardhura.

**28.2.** *Së dyti*, subjekti është kontradiktor në raport me vlerën e deklaruar të të ardhurave nga qiraja, e cila është e ndryshme në deklaratën *vetting* në raport me shumatoren e vlerave të deklaruar në deklaratat periodike të pasurive në vitet 2004-2016<sup>30</sup>. Në deklaratat periodike të pasurisë, subjekti nuk ka specifikuar kontratat e qirasë, qiramarrësit dhe vlerat respektive për secilën prej tyre, duke bërë deklarime të përgjithshme e të paplota, pavarësisht qartësimeve në formularë për deklarim të të dhënave konfidenciale të identitetit të personit fizik apo juridik me të cilën ekziston marrëdhënia e interesit. Në këtë situatë faktike, deklaratat periodike të pasurisë prej vitit 2004, ku subjekti deklaroi të ardhura nga qiratë në vlerë dhe në kolonën përkatëse të titulluar *“emërtimi i aktivitetit nga i cili janë siguruar të ardhurat, adresat përkatëse”*, deklaroi vetëm zyra, si edhe bar-bilardo për vitet 2004 e 2005, nuk mund të shërbejnë si provë për sa subjekti nuk ka deklaruar të dhëna për aktin përkatës, subjektin qiramarrës, periudhën dhe çmimin e qirasë.

**28.3.** *Së treti*, në drejtim të provueshmërisë së të ardhurës së ligjshme, subjekti si mbartës i barrës së provës, për të provuar burimet e krijimit të pasurive të tij, ka dështuar të provojë pagimin e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, pavarësisht se ishte përfitues i tyre për një periudhë të gjatë kohe. Pretendimi i subjektit se detyrimi për kryerjen e pagesës së tatimit i përkiste qiramarrësve për shkak të qenies si subjekte tatimore është i pabazuar, pasi rezulton se kontratat e qirasë të lidhura mes subjektit apo/dhe bashkëshortes së subjektit me qiramarrësit, identifikojnë këta të fundit si individë dhe jo si persona fizikë, me identitet të ndryshëm juridik nga ai individit. Ata nuk shfaqen në kontratat e qirasë si subjekte tatimore, që mbartin për pasojë edhe detyrime që lidhen me këtë status dhe, për pasojë, as nuk mund të identifikoheshin nga organet tatimore si të tillë. I njëjti konkluzion nxirret edhe nga leximi i deklaratave noteriale që vetë këta persona kanë përpiluar. Ndërsa konfirmojnë se kanë hyrë në marrëdhënien e qirasë për të mundësuar ushtrimin e aktivitetit profesional, për të cilin janë regjistruar në organet tatimore, në asnjë rast këta persona nuk deklarojnë për përgjegjësinë e tyre tatimore, të realizuar ose jo, për pagimin e detyrimit të tatimit në burim. Nga analiza e të

---

<sup>30</sup> *Deklarimet e subjektit në DVP-të për të ardhurat nga qiratë janë si vijon: në DVP/2004: 823.000 lekë-bar bilardo dhe zyrat; në DVP/2005 - 780.000 lekë - bar bilardo dhe zyrat; në DVP/2006: 1.150.000 lekë - dhënë me qira 6 zyra godina 3-katëshe; në DVP/2007: 912.000 lekë - dhënë me qira 4 zyra godina 3-katëshe; në DVP/2008: 940.000 lekë - dhënë me qira ambiente në godinën në administrim nga bashkëshortja, me kontrata qiraje (bashkëlidhur), gjithsej 79.000 lekë në muaj, vjetore 940.000 lekë; në DVP/2009: 1.428.000 lekë - dhënë me qira ambiente në godinën në administrim nga bashkëshortja, me kontrata qiraje (bashkëlidhur), gjithsej 119.000 lekë në muaj, vjetore 1.428.000 lekë; në DVP/2010: 112.800 lekë + 9.000 euro - dhënë me qira ambiente në godinën në administrim nga bashkëshortja, me kontrata qiraje (bashkëlidhur) gjithsej viti 112.800 lekë + 9000 euro; në DVP/2011: 924.000 lekë + 9000 euro - dhënë me qira ambiente në godinën në administrim nga bashkëshortja, me kontrata qiraje (bashkëlidhur); në DVP/2012: 630.000 lekë kati II-të + 9000 euro kati III-të - dhënë me qira ambiente në godinën në administrim nga bashkëshortja; Dokumente justifikues “6 fletë kontrata qiraje”; në DVP/2013: 630.000 lekë kati II-të + 9000 euro kati III-të - dhënë me qira ambiente në godinën në administrim nga bashkëshortja; dokumente justifikues “6 fletë kontrata qiraje”; në DVP/2014: 1.010.000 lekë, dhënë me qira ambiente në godinën në administrim nga bashkëshortja; në DVP/2015: 1.010.000 lekë, dhënë me qira ambiente në godinën në administrim nga bashkëshortja; në DVP/2016: 1.400.000 lekë - dhënë me qira ambiente në godinën në administrim nga bashkëshortja. Kontratat e qirasë me akt noterial, notere A. D. Vlorë, futur në sistemin tatimor.*

gjitha të dhënave dhe ekzistencës së kësaj marrëdhënie në vite, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit minimalisht duhej të ishte ndërgjegjësuar dhe informuar për situatën e shlyerjes së detyrimeve tatimore, të cilat ligjëronin ose jo pasuritë që ai krijonte në vite me këto të ardhura, veprim që nuk rezulton të jetë ndërmarrë në asnjë moment.

**28.4. Së katërti**, në pikën fundore, edhe në këndvështrim të të dhënave që rezultuan nga shkresa e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë me nr. {\*\*\*} prot., datë 16.07.2024, paraqitur nga subjekti me ankimin, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, konstatoi se të ardhurat të cilat mund të konsideroheshin si të ligjshme, në *abstragim* të kundërshtive rreth qëndrimit sa më sipër, do të kapnin vlerën prej 6.618.990 lekësh, e cila, ndonëse do të ulte disi balancën negative të analizës financiare të subjektit, do të konfirmonte sërish një mungesë të burimeve të ligjshme në nivel të lartë lidhur me të.

#### ***Lidhur me të ardhurat nga depozita bankare në ish-Bankën e Kursimeve***

29. Komisioni ka vlerësuar të mospërfshijë në analizën financiare të ardhura nga interesat e depozitave bankare për periudhën 2000-2003, për sa kohë nuk provohet nga komunikimi me bankat që ato të jenë përfituar përpara vitit 2008.
30. Subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat nga depozita bankare e Agjencisë së ish-Bankës së Kursimeve, interesat e përfituara në shumën 202.496 lekë për periudhën 2000-2003, duhet të përlllogariten në analizën financiare. Sipas subjektit, me shkresën e datës 20.03.2023 të Raiffeisen Bank, provohet se shuma fillestare e depozitës në datën 08.05.2000 ka qenë 1.000.000 lekë, e depozituar në emrin e subjektit në llogarinë e kursimit nr. {\*\*\*} dhe kjo depozitë është mbyllur në datën 07.08.2003, me tërheqjen nga llogaria të shumës 1.018.369 lekë.
31. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve në dosjen gjyqësore, e gjen të drejtë këtë pretendim të subjektit. Konkretisht, *së pari*, gjatë hetimit administrativ<sup>31</sup>, subjekti ka deklaruar se gjatë viteve 1990-2000 ka pasur depozita bankare në ish-Bankën e Kursimeve, të cilat më pas i ka kaluar në Raiffeisen Bank, dhe i ka deklaruar në deklaratën e parë të pasurisë. Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka depozituar shkresën kthim përgjigjeje, datë 20.03.2023, nga Raiffeisen Bank, dega Vlorë, sipas së cilës Depozita e Kursimit e Agjencisë së ish-Bankës së Kursimeve Vlorë, në emër të z. Hektor Sinanaj është çelur më datë 08.05.2000 dhe është mbyllur më datë 07.08.2003. Bashkëngjitur kësaj shkrese është përcjellë kopje e kartelës së depozitës së kursimit me nr. llogarie {\*\*\*}, prej nga rezulton se në datën 08.05.2000 në emër të subjektit është çelur depozita në shumën 1.000.000 lekë, e cila është mbyllur në datën 07.08.2003, duke tërhequr të gjithë gjendjen në shumën 1.018.369 lekë, dhe gjatë kësaj periudhe rezulton se subjekti ka përfituar të ardhura nga interesat (pas zbritjes së tatimit) në shumën 227.339 lekë. *Së dyti*, në DPV-në 2003, subjekti deklaroi të ardhura nga përqindjet bankare (depozitat), shuma 1.200.000 lekë, deklarim i cili duket të referojë shumën e tërheqjes së depozitës në ish-Bankën e Kursimeve. *Së treti*, sa më sipër, sipas informacionit dhe dokumentacionit të Raiffeisen Bank, përcjellë me shkresën e datës 20.03.2023, trupi gjykues konstaton se provohet depozitimi i shumës 1.000.000 lekë në llogarinë e kursimit me nr. {\*\*\*}, në emrin e subjektit në datën 08.05.2000, si dhe mbyllja e depozitës në datën 07.08.2003, me tërheqjen e të gjithë shumës nga llogaria. Për rrjedhojë, trupi gjykues, përmes Njesisë së

<sup>31</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. {\*\*\*}, pyetja nr. 7.

Shërbimit Ligjor, vlerësoi kryerjen e korigjimeve përkatëse në analizën financiare, duke reflektuar krijimin e depozitës në shumën 1.000.000 lekë në vitin 2000, si dhe tërheqjen e shumës prej 1.227.339 lekësh (1.000.000 lekë principal + 227.339 lekë interesa) në vitin 2003<sup>32</sup>, deri në momentin e mbylljes së depozitës<sup>33</sup>.

***Lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit si person fizik, administratore e subjektit “L. S.”, me NIPT {\*\*\*}***

32. Në deklaratën vetting, subjekti deklaron të ardhura nga biznesi që kryen bashkëshortja L. S. - aktivitet të arsimit fillor për vitet 2008-2016, me NIPT {\*\*\*}, sipas vërtetimit nr. {\*\*\*}, datë 26.10.2016, të DRT-së Vlorë dhe faturës së kasës 2016 në vlerën 12.704.858 lekë.
33. Komisioni, referuar informacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të DRT-së Vlorë<sup>34</sup>, përmes së cilave janë përcjellë të dhëna për të ardhurat dhe fitimin e deklaruar për subjektin tregtar “L. S.”, me NIPT {\*\*\*}, me administratore bashkëshorten e subjektit, prej të cilit për periudhën 2008-2016 ka rezultuar totali i të ardhurave prej 5.178.000 lekësh, ka përfshirë në analizën financiare vlerën e fitimit të konfirmuar nga DRT-ja Vlorë.
34. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka vlerësuar drejt të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti kopsht privat për vitet 2013-2014. Sipas subjektit, këto të ardhura janë deklaruar në mënyrë të saktë në deklaratimet periodike të pasurisë, në vlera më të larta krahasuar me ato që figurojnë në sistemin tatimor, se mospërputhja vjen për shkak të ndryshimit të menaxhimit të sistemit tatimor në ato vite, duke kaluar nga pushteti vendor te Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, dhe se pasaktësitë kanë qenë të pranishme në pjesën më të madhe të subjekteve tatimore në atë kohë.
35. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me të dhënat e rezultuara nga aktet në dosjen gjyqësore, konstaton dhe vlerëson si vijon.

35.1. *Së pari*, në DPV-të e vitit 2013 dhe të vitit 2014, subjekti deklaron të ardhura nga biznesi kopsht fëmijësh administruar nga bashkëshortja me NIPT {\*\*\*}, respektivisht në shumën 1.900.000 lekë dhe në shumën 1.700.000 lekë, të cilat i referohen të ardhurave vjetore dhe jo fitimit të realizuar. *Së dyti*, në përgjigjet për pyetësin standard<sup>35</sup>, fitimin nga ky aktivitet subjekti e deklaroi në shumën 524.702 lekë për vitin 2013, sikundër e ka përllogaritur edhe Komisioni, dhe në shumën 153.221 lekë për vitin 2014. Subjekti ka shpjeguar se *informacioni për periudhën e vitit 2014 ka pasur një ngatërresë, pasi në atë kohë u aplikua për herë të parë kasa fiskale dhe pati lapsus në vetdeklarimin e financierit për llogaritjen e shitjeve, të cilat nuk u korigjuan në afatet e mundshme, të ardhurat e sakta janë vetëm ato që ka deklaruar në ILDKPKI. Së treti*, në raportin e ekspertit kontabël, të paraqitur prej subjektit si provë me

---

<sup>32</sup> Të ardhurat e përfituara nga interesat e kësaj depozite deri në vitin 2002 janë në shumën 180.985 lekë, ndërsa për vitin 2003 është pakësuar depozita në shumën 1.000.000 lekë (referuar kartelës së depozitës) dhe janë përllogaritur interesat e përfituara në shumën 46.354 lekë.

<sup>33</sup> Në datën 16.05.2003, subjekti ka tërhequr interesat e akumuluar në shumën 208.970 lekë dhe, më pas, në datën e mbylljes së depozitës ka tërhequr shumën e mbetur prej 1.018.369 lekësh.

<sup>34</sup> Shkresë e DRT-së Vlorë me nr. {\*\*\*} prot., datë 30.06.2023, shkresë e DPT-së me nr. {\*\*\*} prot., datë 8.03.2021, bashkëlidhur së cilës janë përcjellë deklaratat tatimore mbi fitimin vitet 2014-2020, deklaratat e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për vitet 2008 -2013.

<sup>35</sup> Për pyetjen nr. 16 “Nëse ju apo ndonjë anëtar i familjes suaj keni përfutur të ardhura nga një aktivitet biznesi privat gjatë periudhës së deklaratimit, lutemi shënoni të ardhurat neto që janë fituar për çdo vit për secilin aktivitet biznesi.”

parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, në analizën financiare, të ardhurat nga aktiviteti privat për vitin 2014 janë përlllogaritur në shumën 1.224.124 lekë<sup>36</sup>. Së katërti, nga informacioni i përcjellë nga institucionet shtetërore, lidhur me fitimin nga ky aktivitet për vitin 2014, konstatohet se: sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 10.08.2017, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë dhe shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, fitimi rezulton në shumën 153.221 lekë, ndërkohë sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 26.06.2023, të Drejtorisë Rajonale e Tatimeve Vlorë, ku fitimi pasqyrohet duke filluar nga viti 2014 deri në vitin 2022, rezulton në shumën 86.779 lekë.

35.2. Sa më sipër, lidhur me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit si person fizik, administratore e subjektit “L. S.”, me NIPT {\*\*\*}, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit, shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2021 dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, Deklarata e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin për vitet 2014-2020, si dhe Deklarata e Tatimit mbi të Ardhurat Personale të Biznesit të Vogël për vitet 2008-2013, trupi gjykues konstaton se fitimi për vitin 2014 rezulton në shumën 153.221 lekë, ndërsa sipas informacionit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.06.2023, shuma prej 86.799 lekësh duket të jetë vlera e shpenzimeve dhe jo fitimit. Për rrjedhojë, në analizën financiare të Komisionit, ku fitimi i realizuar nga bashkëshortja e subjektit në vitin 2014 ishte përlllogaritur në shumën 86.799 lekë, u krye korrektimi përkatës, duke e përlllogaritur atë në shumën 153.221 lekë, ndërsa pretendimi i subjektit për korrigjim të të ardhurave nga ky aktivitet për vitin 2013 u gjet i pabazuar.

### ***Ç. Në lidhje me deklaratimet për pasuritë***

36. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit *se nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasurinë, sipas pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës*, është i pabazuar, sepse çdo pasuri është deklaruar e plotë sipas gjendjes juridike që figuron edhe në regjistrat publikë.
37. Trupi gjykues, pasi mori në analizë pretendimet e subjektit, në drejtim të konstatimeve për deklaratime të pasakta, i gjeti të drejta konkluzionet e Komisionit vetëm sa i përket atyre të kryera në deklaratën *vetting*, konkretisht për pasuritë, godinë 3-katëshe me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup> dhe shtesën mbi njësinë me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup>, të ndodhura në Vlorë, të cilat konsistojnë në përcaktimin e kohës së ndërtimit, kostove respektive dhe burimeve të krijimit të tyre. Duke sjellë në vëmendje se në konkluzionin përfundimtar lidhur me kriterin e pasurisë *subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016*, Komisioni, siç ka konstatuar në vendim, ka marrë në konsideratë edhe se *subjekti nuk ka paraqitur në mënyrë të saktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose përdorim të tij dhe personave të lidhur*, trupi gjykues analizoi si vijon.
38. *Pasuria godinë 3-katëshe (kati i parë me destinacion zyra dhe 2 kate banimi), në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë*

38.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti e deklaroi këtë pasuri si vijon: *Godinë 3-katëshe (kati i parë me destinacion zyra dhe 2 kate banimi), me nr. pasurie {\*\*\*} e {\*\*\*}, z. k. {\*\*\*}, me*

---

<sup>36</sup> Të ardhurat e realizuara për vitin 2014 në shumën 1.700.000 lekë deklaruar në DPV-në e vitit 2014 \* 72.01% përlllogaritur si fitimi mesatar për vitet 2009-2012.

sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>, ndërtuar nga fundi i vitit 1992, rikonstruktuar me lejet e ndërtimit nr. {\*\*\*}, datë 13.07.2001 dhe nr. {\*\*\*}, datë 15.05.2001, sheshit të ndërtimit dhënë nga KRRt Bashkia Vlorë, me destinacion banesë 2 kate plus zyra në katin e parë. Regjistruar si karabina në ZVRPP-në Vlorë me nr. {\*\*\*}, datë 29.10.2004, z. k. {\*\*\*}, vazhduar punimet deri në mars të vitit 2006, ndërprerë për shkak të përfundimit të afatit të lejes, mbetur pa u përfunduar çatia sipas projektit. Nga viti 1993 ambientet e godinës, fillimisht me firmën e ndërtimit "{\*\*\*}", me të cilën kam lidhur kontratën datë 20.05.1993, kemi përshtatur ambientet e katit përdhe si zyrë avokatie e më pas bar-bilardo, plus zyrë avokatie. Pas marrjes së lejes së rikonstruksionit, në katin e parë (mbi katin përdhe) nga kursimet familjare, si dhe me kredi bankare nga BKT-ja, kam përshtatur gjithsej 9 zyra, të cilat i ka dhënë me qira bashkëshortja me kontrata të rregullta me qiramarrësit. Më pas, kati përdhe është përshtatur si kopsht fëmijësh në administrim nga bashkëshortja me NIPT {\*\*\*}. Burimi i krijimit: kursimet familjare, të ardhurat nga puna si avokat, pagat si përmbarues, sekretar, gjyqtar. Të ardhurat nga kopshti privat, dhënia me qira e zyrave, të ardhurat nga depozita bankare në BKSh, BKT, Raiffeisen Bank, Credit Agricole (ish-Emporiki Bank). Kredi bankare në shumën 20.000 USD në BKT, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.04.2005, kontratë hipoteke pasurie nr. {\*\*\*}, z. k. {\*\*\*}. Kontratë huadhënieje me interes 6% në muaj, në shumën 1.000.000 lekë, sipas vendimit nr. {\*\*\*}, datë 10.05.1996, huadhënës biznesmeni A. M. Pagesat e qirave janë bërë edhe në euro. Gjatë punës si avokat kam bërë edhe shkëmbim valute, nga ku kam nxjerrë përfitime në të të ardhura në treg të lirë. Pasi u hoq dënimi me vdekje dhe u rritën pagat e gjyqtarëve, si dhe kisha të ardhura nga biznesi, bar-bilardo, kopsht e zyra me qira, kalova gjyqtar më 6.3.2000. Vlera gjithsej sipas situacionit pas rikonstruksionit, në shumën 9.194.890 lekë. Pjesa takuese: 100%.

**38.2.** Komisioni, për këtë pasuri, në përfundim, ka konkluduar se subjekti nuk arriti të provojë se burimet për krijimin e kësaj pasurie kanë qenë të krijuara në mënyrë të ligjshme, referuar standardit dhe kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Ky përfundim është mbështetur në vlerësimin se: rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar profesionin e avokatit për periudhën 1992-1999, duke u regjistruar si person fizik në organet tatimore me kodin fiskal përkatës, pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore për pagën minimale, mandatpagesat pranë Bankës së Shtetit dhe Bankës së Kursimeve, mandatpagesat për kryerjen e pagesës pranë zyrës së tatimeve etj., gjithashtu, subjekti ka bërë deklaram të detajuar në deklaratën e parë (viti 2003) për të ardhurat e realizuara për çdo vit të kryerjes së këtij aktiviteti, dhe nga institucionet konfirmohen pagesat për shlyerjen e detyrimeve tatimore prej tij në vitet 1998-1999. Duke u nisur nga koha e gjatë e arkivimit të të dhënave, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka mundësi të provojë shumat konkrete të përfituara prej tij apo/dhe shumat e detyrimeve tatimore të shlyera prej tij për këtë aktivitet, ka vlerësuar të përfshijë në analizën financiare të ardhurat *neto* nga ushtrimi i veprimtarisë së avokatisë të llogaritura me marzhin e fitimit 90% për qarkullimin minimal prej 2.000.000 lekësh në vit, për periudhën shtator 1992-1999, në shumën totale prej 13.500.000 lekësh. Edhe pas përfshirjes së kësaj shume në analizën financiare, për periudhën e investimit 1992-2006, situata financiare ka rezultuar në balancë negative prej (-) 9.805.956 lekësh, në vlerë totale për këtë periudhë.

**38.3.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se pasuria godinë 3-katëshe me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup> është deklaruar sipas të gjithë historikut të krijimit të saj prej vitit 1992 deri në ditët e sotme, me

çdo dokumentacion ligjor dhe shpjegim të nevojshëm për të. Sipas subjektit: (i) në vendimin e Komisionit (paragrafi 35 e vijues, të cilët i korrespondojnë rivlerësimit të kësaj pasurie) nuk pasqyrohet asnjë konstatim për mungesë saktësie në deklarimin e kësaj pasurie; (ii) pasuria është deklaruar *rikonstruksion* për të theksuar faktin se ka qenë ekzistuese, njëkatëshe përpara marrjes së lejes së ndërtimit në datën 13.07.2001 dhe datën 15.05.2001; (iii) pretendimi se nuk është dorëzuar dokumentacion i plotë është i pabazuar, sepse dokumentacioni është vënë në dispozicion, pavarësisht se daton herët në kohë; (iv) sipas një analize financiare të drejtë, me përfshirjen e të ardhurave nga qiratë dhe të ardhurave të depozituara në bankë, nuk do të rezultonte mungesë e burimeve financiare për krijimin e kësaj pasurie; (v) Komisioni ka vlerësuar se vlera e investimit përputhet me vlerat e referencave të EKB-së për vitet 2001-2005, nga sa rezulton se shumatat e deklaruara prej tij në deklaratat periodike të pasurisë janë të përafërta me vlerat e këtyre referencave.

**38.4.** Trupi gjykues, *së pari*, konstaton se në deklaratën *vetting* për këtë pronë subjekti deklaroi ndërtuar nga fundi i vitit 1992, rikonstruktuar me lejet e ndërtimit nr. {\*\*\*}, datë 13.7.2001 dhe nr. {\*\*\*}, datë 15.05.2001, të sheshit të ndërtimit dhënë nga Bashkia Vlorë dhe, gjatë gjithë deklaramëve të tij në Komision, subjekti ka deklaruar për rikonstruksion të godinës me lejet e deklaruara, ndërsa në asnjë pikë të vendimit të KRRt-së për miratimin dhe as në aktin e lejes së ndërtimit<sup>37</sup> nuk flitet për rikonstruksion, por për ndërtim të ri mbi një shesh me sip. 206 m<sup>2</sup>. Në këtë kontekst, konsideruar edhe deklaramët e subjektit *se me vendimet {\*\*\*}, datë 15.05.2001 të sheshit të ndërtimit dhe lejes së ndërtimit nr. {\*\*\*}, datë 13.07.2001, të KRRt së Bashkisë Vlorë u miratua ndërtimi “Banesë 2 kate dhe zyra në katin e parë”*<sup>38</sup>, pretendimi se pasuria godinë 3-katëshe është deklaruar rikonstruksion për të theksuar faktin se ka qenë ekzistuese, njëkatëshe përpara marrjes së lejes së ndërtimit në datën 13.07.2001 dhe datën 15.05.2001, vlerësohet haptazi i pabazuar. Gjithashtu, konstatohet se kërkesa e Komisionit për të dhënë shpjegime të shoqëruara me dokumentacion ligjor për pasurinë objekt, të ndërtuar me lejen e ndërtimit nr. {\*\*\*}, datë 13.07.2001, i shoqëruar me dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor të lejes së sheshit të ndërtimit, lejes së ndërtimit dhe regjistrimit të pasurisë (duke përfshirë edhe planvendosjen e saj)<sup>39</sup> ka mbetur pa përgjigje prej subjektit, i cili ka depozituar edhe një herë shpjegimet dhe dokumentacionin e depozituar më parë<sup>40</sup>. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit, se për këtë pronë ka deklaruar sipas të gjithë historikut të krijimit të saj prej vitit 1992 deri në ditët e sotme, me çdo dokumentacion ligjor dhe shpjegim të nevojshëm për të, vlerësohet i pabazuar. *Së dyti*, përpos mospërputhjeve të konstatuara në deklaratat vjetore të pasurisë mbi sipërfaqen e truallit mbi të cilën është ndërtuar godina 3-katëshe, lidhur me burimet e krijimit të pasurisë, konstatohet se të ardhurat nga qiratë, për të cilat u analizua gjërësisht më sipër, veçanërisht ato që i korrespondojnë periudhës së investimit nuk mbështeten

<sup>37</sup> Me vendimin e KRRt-së nr. {\*\*\*}, datë 15.05.2001 “Për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane”, është vendosur që investitorit Hektor Sinani ti miratohet sheshi i ndërtimit banesë 2 kate+ zyra në katin e parë në lagjen “{\*\*\*}”. Sipërfaqe e sheshit 206 m<sup>2</sup>. Sipërfaqe ndërtimi 130 m<sup>2</sup>. Numri i kateve (tre), numri maksimal i kateve 3 (tre), koeficienti i shfrytëzimit të territorit 63%. Numri i kateve mbi tokë 3 (tre).

<sup>38</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. {\*\*\*}.

<sup>39</sup> Përmes pyetësorit nr. {\*\*\*}.

<sup>40</sup> Fotokopje të kontratës së ndërtimit datë 20.05.1993 (bashkëlidhur kopje mandatarkëtimi nr. {\*\*\*}, në shumën 100.000 lekë, datë 10.11.1993); kontratë datë 10.08.2001, për punime me shoqërinë ndërtuese “{\*\*\*}” ShPK; mandatarkëtim datë 24.10.2004, për shumën 2.250 lekë; kopje preventivi (mungon koha e përpilimit të këtij preventivi dhe viti i shpenzimeve të bëra për secilin kat) të k/teknikut, për punimet në fazën e ndërtimit të godinës trekatëshe për ambientet e katit të dytë dhe të tretë, gjithsej për të dyja katet në vlerën 1.409.000 lekë x 2 = 2.818.000 lekë.

në asnjë dokumentacion provues, përveçse në deklarimet e subjektit. Gjithashtu, subjekti pretendon përfshirjen e të ardhurave nga kopshti privat, si burim për ndërtimin e godinës, ndërkohë që regjistrimi i këtij aktiviteti në MASH dhe në drejtoritë tatimore është kryer në vitin 2008, ndërsa ndërtimi kishte përfunduar në vitin 2006, duke e bërë të papranueshëm këtë pretendim. Për sa më sipër, grupi i pretendimeve të subjektit, lidhur me këtë pasuri, vlerësohet prej trupit gjykues i pabazuar.

### 39. *Pasuria njësi (magazinë) me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup>, në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë*

**39.1.** Në deklaratën vetting, subjekti deklaron: “4. Pasuria nr. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, njësi 60 m<sup>2</sup>, dhe trualli i njësisë nr. {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, me certifikatat përkatëse të pronësisë lëshuar në datën 08.09.2006. Mbi katin ekzistues, legalizuar shtesë kati me nr. pasurie {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, faqe {\*\*\*} lëshuar certifikata e pronësisë, datë 04.01.2011. Burimi i krijimit: blerë me kontratën e shitjes noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.08.2001, nga unë Hektor Sinanaj, nga shitësi bashkëpronar I. e S. K., në shumën 650.000 lekë. Kati i sipërm nr. {\*\*\*}, legalizuar me pagesën e legalizimit, datë 25.05.2009, në shumën 17.951 lekë, si dhe taksë shërbimi 4.000 lekë. Shtesa e katit është ndërtuar me kursimet familjare dhe pjesërisht edhe nga kredia bankare marrë në BKT 20.000 USD, në periudhën 2002-2005. Në katin e parë dhe të dytë janë bashkuar ambientet e pasurisë nr. {\*\*\*} me pasurinë nr. {\*\*\*}, duke u saktësuar në ZVRPP sipërfaqja e pasurisë nr. {\*\*\*} nga 56 m<sup>2</sup> në 60 m<sup>2</sup>. Vlera gjithsej sipas situacionit 01.07.2005-31.03.2006 në shumën 1.645.290 lekë. Pjesa takuese: 100%”.

**39.2.** Komisioni, lidhur me këtë pasuri ka konkluduar se subjekti nuk arriti të provojë se burimet për krijimin e kësaj pasurie kanë qenë të krijuara në mënyrë të ligjshme, referuar standardit dhe kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Ky përfundim, mbështetet në vlerësimin se edhe pas kalimit të barrës së provës<sup>41</sup>, subjekti i rivlerësimit përforcoi qëndrimet e tij kontradiktore lidhur me kohën dhe vlerën e këtij investimi, duke e bërë të pamundur analizën financiare dhe kontrollin e ligjshmërisë së krijimit të kësaj pasurie. Në lidhje me analizën financiare, në mungesë të deklaramit në mënyrë të qartë dhe të pambështetur në prova të vlerës së ndërtimit, Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk shpjegoi në mënyrë shteruese pamundësinë financiare të rezultuar prej (-) 2.318.540 lekësh.

**39.3.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se pasuria njësi më sipërfaqe 60 m<sup>2</sup> dhe trualli i njësisë me certifikatën e pronësisë lëshuar në datën 08.09.2006, është deklaruar sipas historikut të krijimit të saj dhe pagesat e bëra për të, se është vënë në dispozicion vlera e blerjes dhe

---

<sup>41</sup> Komisioni me raportin për rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, në lidhje me këtë pasuri i ka kaluar subjektit barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve:

- Në lidhje me deklaramin e objektit ish-magazinë duket se ka mospërputhje të vlerës së deklaruar për blerjen e ish-magazinës në DPV 2003 - shuma 1 milion dhe në kontratë e shitblerjes në vitin 2001 - në shumën 650.000 lekë;
- Në lidhje më shtesën e ish-magazinës me proces legalizimi (kaluar njësi në vitin 2006): (i) duket se nuk është deklaruar shtesa (në proces legalizimi) në deklarimet e viteve DPV/2005, DPV/2006, DVP/2007, DPV/2008, DPV/2009 dhe DPV/2010, në cilin vit ka filluar dhe mbaruar ndërtimi i shtesës së katit dhe se sa ka qenë vlera e shpenzuar për shtesën në secilin vit; (ii) duket se subjekti nuk deklaroi në DPV/2011 vlerën e investimit dhe burimin e krijimit të shtesës; (iii) duket se subjekti bëri deklaram të paqartë se sa ka qenë vlera e investimit në secilin vit por e deklaroi në total të gjithë vlerën në shumën 1.645.290 lekë, duke e bërë të pamundur analizën e plotë të kësaj pasurie në kuptim të ligjit nr. 84/2016;
- Në lidhje me burimin e krijimit duket se subjekti rezultoi me pamundësi financiare për ndërtimin e shtesës në vlerën totale të saj prej (-)2.318.540 lekësh.

investimit për të, në mënyrë që të ishte funksionale. Sipas tij, investimi i kryer për qëllime funksionaliteti dhe mirëmbajtjeje, ka përfunduar me regjistrimin në përputhje me ligjin në ASHK-në Vlorë, dhe për këtë investim është pasqyruar qartë edhe periudha 01.07.2005-31.03.2006. Në këto kushte është i pabazuar qëndrimi i Komisionit për deklarim të pasaktë, pretendoi subjekti duke potencuar se nëse kjo pasuri do të rivlerësohej me përfshirjen e të ardhurave nga qiraja në analizën financiare, do të ndryshonte balanca negative.

**39.4.** Trupi gjykues, nga aktet në dosje konstaton, *së pari*, se me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.08.2001, subjekti ka blerë nga shitësit I. e S. K. pasurinë magazinë me nr. pasurie {\*\*\*}, në lagjen “{\*\*\*}”, me përmasa  $16 \times 3,5 = 56 \text{ m}^2$  (kufitar nga pjesa veriore Hektor Sinani), kundrejt vlerës 650.000 lekë, shumë e likuiduar plotësisht, sipas parashikimit në kontratë. Pas regjistrimit në regjistrat hipotekorë në vitin 2006<sup>42</sup>, në datën 06.11.2006, subjekti ka vetëdeklaruar ndërtimin e objektit shtesë papafingo me sipërfaqe  $60 \text{ m}^2$  mbi soletën e objektit ekzistues (ish-magazinë) njësi me sipërfaqe  $60 \text{ m}^2$ , është pajisur me leje legalizimi nr. {\*\*\*}, datë 18.10.2010<sup>43</sup> - shtesë një kat për shërbim në objektin ekzistues I kat, Vlorë - dhe më pas e ka regjistruar pasurinë në ASHK<sup>44</sup>. Së dyti, në DVP-në e vitit 2003, subjekti deklaroi pasurinë *godinë magazinë me sipërfaqe  $56 \text{ m}^2$  në lagjen “{\*\*\*}” Vlorë, blerë me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.08.2001, vlera 1 milion*; në DVP-të e viteve 2004, 2005 dhe 2006, deklaroi vazhdim të ndërtimit/punimeve në godinën 3-katëshe dhe vlerat përkatëse; në DVP-në e vitit 2006 deklaroi se: *pjesa tjetër e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme që kam deklaruar më parë nuk ka ndryshime*; në DVP-në e vitit 2011 deklaroi: *“nuk ka ndryshim në pasuritë e paluajtshme, legalizuar shtesa  $60 \text{ m}^2$  paguar legalizimi i shtesës  $60 \text{ m}^2$  në shumën 16.000 lekë”*; referuar procesverbalit të mbajtur në ILDKPKI në vitin 2015<sup>45</sup>, rezultoi se subjekti nuk është përgjigjur për kohën kur është ndërtuar shtesa, për vlerën e shpenzimeve për ndërtimin e saj, si dhe për mos deklarimin e saj. Së treti, në përgjigje të pyetësorëve<sup>46</sup>, ndër të tjera, subjekti deklaroi: *“Objekti shtesa anësore për kopsht fëmijësh,*

<sup>42</sup> Certifikatë pronësie datë 08.09.2006, për pasurinë truall nr. {\*\*\*} me sipërfaqe  $60 \text{ m}^2$ , e ndodhur në z.k. nr. {\*\*\*}, lagja “{\*\*\*}”, Vlorë, në pronësi të shtetasit Hektor Sinani. Bashkëngjitur kopje kartelesh dhe hartë treguese për këtë pasuri. Certifikatë pronësie, datë 08.09.2006, për pasurinë njësi nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe  $60 \text{ m}^2$ , e ndodhur në z.k. nr. {\*\*\*}, rruga {\*\*\*}, Vlorë, në pronësi të shtetasit Hektor Sinani. Bashkëngjitur kopje kartelesh dhe hartë treguese për këtë pasuri.

<sup>43</sup> Bashkëngjitur përgjigjes së ASHK-së me shkresat nr. {\*\*\*} prot., datë 16.03.2021 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 10.07.2023, që konfirmojnë se subjekti i rivlerësimit rezultoi aplikues në procesin e legalizimit në datën 06.11.2006 Vlorë, janë përcjellë: genplan; ortofoto; planimetri; mandatpagesë, datë 30.04.2009, në shumën 4.300 lekë, kryer nga shtetasi Hektor Sinanaj, në favor të ALUZNI-t, si dhe formular i tarifës së shërbimit në vlerën 4.000 lekë; mandatpagesë, datë 25.05.2009, në shumën 17.951 lekë, i kryer nga shtetasi Hektor Sinanaj, në favor të ALUZNI-t, si dhe formular i tarifës së shërbimit në shumën 16.951 lekë, që i takon 1% e vlerës së investimit në shumën 1.695.120 lekë. Bashkëlidhur me aktet janë edhe kopje të certifikatave të vërtetimit të pronësisë për truallin, njësinë dhe shtesën (secila me sipërfaqe  $60 \text{ m}^2$ ).

<sup>44</sup> Certifikatë pronësie, datë 04.01.2011, për pasurinë njësi nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe  $60 \text{ m}^2$ , e ndodhur në z.k. nr. {\*\*\*}, lagja “{\*\*\*}”, Vlorë, në pronësi të shtetasit Hektor Sinani. Bashkëngjitur kopje kartelesh dhe hartë treguese për këtë pasuri.

<sup>45</sup> Për pyetjen: *“Në deklarimin periodik vjetor të vitit 2011, ju keni deklaruar legalizuar shtesë  $60 \text{ m}^2$  e deklaruar më parë. Paguar legalizimi i shtesës  $60 \text{ m}^2$  në shumën 16.000 lekë. Kur është ndërtuar kjo njësi, sa ka qenë shpenzimi për ndërtimin e saj dhe pse nuk e keni deklaruar?”* Përgjigja e subjektit ka qenë: *“Kjo njësi i përket magazinës me sipërfaqe  $56 \text{ m}^2$  të deklaruar në vitin 2003 e cila kur është legalizuar në vitin 2011, kjo sipërfaqe është saktësuar  $60 \text{ m}^2$ ”*.

<sup>46</sup> Në pyetësorin nr. {\*\*\*}, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime të shoqëruara me dokumentacion ligjor për kohën e fillimit të ndërtimit dhe mbarimit të ndërtimit të shtesës të kryer në objekt; vlerën e investimit të kryer për shtesën, të ndarë sipas viteve përkatëse; vlerën e investimit në godinën ish-magazinë, kthyer në njësi; nëse ka kryer punime të tjera ndërtimi përveç shtesës së legalizuar me lejen e legalizimit nr. {\*\*\*}, datë 18.10.2010, dhe sa është vlera e tyre.

lagja “{\*\*\*}”, investimi i katit të parë dhe dytë janë bashkuar me ambientet e pasurisë, kapin shumën 1.645.290 lekë, duke u saktësuar në ZVRPP sipërfaqja e pasurisë nr.{\*\*\*}, nga 56m<sup>2</sup> në 60 m<sup>2</sup> [...] shtesa në katin e dytë, ishte e filluar nga ish pronari i mëparshëm, ekzistonte, ngritur me disa hekura vertikale që mbanin një si çati një mbulesë me llamarinë të valëzuar, e cila u zëvendësua nga unë, duke u ndërtuar me materialet e përshkruara në situacion [...] deklarimi mban datën 06.11.2006, që përkon pas përfundimit të shtesës që ka përfunduar sipas situacionit më 31 mars 2006” dhe se vlera e investimeve të kryera për shtesën, të ndarë sipas viteve përkatëse, në godinën ish-magazine, kthyer në njësi, del nga përshkrimi në këto deklarata të investimeve. Me parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, ku nga analiza financiare subjekti ka rezultuar me pamundësi financiare për ndërtimin e shtesës në vlerën (-) 2.318.540 lekë, subjekti deklaron: “Për vlerën totale prej 2.318.540 lekësh duhet sqaruar se përbëhet nga shuma e përgjithshme e vlerës së investimit dhe vlerës së kontratës së shitblerjes; vlera e deklaruar në DVP-në e vitit 2003, prej 1.000.000 lekësh, nuk përbën vlerën e kontratës së shitblerjes por është edhe vlerë investimi, në funksion të dy pasurive, pasi godina trekatëshe qëndron e bashkuar me njësinë e regjistruar veçmas; në proces legalizimi nuk ka pasur ndërtim shtesë, por është regjistruar restaurimi i njësisë ekzistuese të blerë me kontratën e shitjes noteriale të datës 14.08.2001; çdo investim është deklaruar çdo vit dhe për investimet është realizuar preventivi; për vlerën e investimit prej 1.645.290 lekësh është e pasqyruar qartë edhe periudha e investimit 01.07.2005- 31.03.2006”.

**39.5.** Sa më sipër, përpos se në deklaratat e pasurisë dhe në deklaratat në ILDKPKI, subjekti nuk ka deklaruar investimin në këtë pasuri, kohën dhe vlerën e tij, deklaratat e tij në Komision janë kontradiktore lidhur me kohën dhe vlerën e investimit në këtë pasuri. Konkretisht, lidhur me kohën e ndërtimit të shtesës, në deklaratën vetting subjekti deklaron periudhën 2002-2005, në përgjigje të pyetësorëve deklaron që ka përfunduar sipas situacionit më 31.03.2006, dhe në parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ kryesisht deklaron periudhën 01.07.2005-31.03.2006. Pretendimet e subjektit në ankim për investim për qëllime funksionaliteti dhe mirëmbajtjeje, në Komision se në proces legalizimi nuk ka pasur ndërtim shtesë, por është regjistruar restaurimi i njësisë ekzistuese të blerë me kontratën e shitjes noteriale të datës 14.08.2001, të cilat rezultojnë haptazi të pabazuara referuar dokumentacionit të administruar nga ALUIZNI, përforcojnë qëndrimet kontradiktore të subjektit në funksion të mosprovueshmërisë së vlerës së investimit. Lidhur me vlerën e investimit, përpos se nuk është deklaruar në asnjë prej deklaratave të pasurisë ndër vite, me deklaratat e tij në Komision, subjekti krijon konfuzion. Pretendimet se në DVP-në e vitit 2003 vlera prej 1 milion lekësh nuk përbën vlerën e kontratës së shitblerjes por është edhe vlerë investimi, vlerësohet haptazi e pabazuar për sa në këtë deklaratë deklarohet vetëm kontrata e shitblerjes dhe jo investime në këtë pasuri, për më tepër, në DVP-të e viteve 2004-2006, subjekti deklaron vetëm investime në godinën 3-katëshe, dhe në DVP-në e vitit 2006 deklaron se nuk ka ndryshime në pasuritë e deklaruar më parë. Po ashtu, duke ja atribuar fillimet e punimeve për shtesën mbi objektin magazinë shitësit, si dhe duke deklaruar se: *investimi i katit të parë dhe të dytë janë bashkuar me ambientet e pasurisë dhe kapin shumën 1.645.290 lekë*, ndërkohë që referuar dokumentacionit të ALUIZNI-it vlera e investimit vetëm për objektin shtesë mbi soletën e objektit magazinë rezulton në shumën 1.695.120 lekë, subjekti ka përforcuar qëndrimet e tij kontradiktore lidhur me vlerën e investimit në këtë pasuri. Lidhur me burimet e krijimit të

kësaj pasurie, të cilat deklarohen edhe për krijimin e pasurisë godinë 3-kate, në Vlorë, në kushtet kur subjekti rezulton kontradiktor sa i përket kohës dhe vlerës së investimit, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se pamundësohet analiza financiare dhe kontrolli i ligjshmërisë së krijimit të kësaj pasurie, dhe se subjekti nuk shpjegon në mënyrë bindëse pamundësinë financiare të rezultuar gjatë hetimit administrativ prej (-) 2.318.540 lekësh. Për sa më sipër, trupi gjykues i vlerëson pretendimet e subjektit, të pabazuara.

**40. Pasuria shtëpi banimi me sipërfaqe trualli 162 m<sup>2</sup> në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë**

**40.1.** Në deklaratën *vetting*, lidhur me këtë pasuri, subjekti deklaron: “1. Shtëpi banimi me sipërfaqe trualli 162 m<sup>2</sup> në lagjen “{\*\*\*}” Vlorë, z.k. {\*\*\*}, nr. pas {\*\*\*}. Burimi i krijimit: Trashëgimi. Rikonstruktuar me shpenzimet e kryera nga data 04.12.1992 deri në dhjetor 2004. Shpenzime për pasurinë nr. {\*\*\*}, sipas situacionit periudha 01.01.2003 – 31.12.2005, sipas faturave e deklaratave që disponoj të punimeve, duke zbritur vlerën e banesës ekzistuese (me akt dhurimi) rikonstruktuar është në shumën 1.668.540 lekë. Pjesë takuese: 100%”. Pas një përshkrimi të gjatë në deklaratën *vetting*<sup>47</sup>, lidhur me dhurimin nga nëna të ½ pjesë takuese, në datë 30.10.1992, shitjes prej tezes së ½ pjesë takuese te vjehri i subjektit, dhe dhurimin prej këtij të fundit të kësaj pjese te subjekti me akt dhurimin përkatës, në datën 13.04.1995, deklaron shpenzime për rikonstrukcion në vlerën 1.668.540 lekësh, me burim krijimi nga puna e tij dhe e bashkëshortes nga data 29.06.1983 e në vijim.

**40.2.** Komisioni, lidhur me këtë pasuri, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se burimet për krijimin e kësaj pasurie kanë qenë të krijuara në mënyrë të ligjshme, referuar standardit dhe kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë përfundim, Komisioni ka çmuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë një

---

<sup>47</sup> Subjekti vazhdon deklarinimin në deklaratën *vetting*: “Shtëpia ekzistuese ka qenë në pronësi të gjyshit nga nëna B. G., sipas notë transkriptimit me nr. radhor {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, datë 21.08.1936. Më është dhuruar nga nëna ime gjysma e banesës, me akt dhurimin datë 30.10.1992. Gjysma tjetër e banesës në pronësi të tezes sime M. H. (G.), duke pasur kontradikta për posedimin, ia shiti vjehrit tim S. R., i cili më pas ma kaloi me akt dhurimin nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 13.04.1995, duke kaluar e regjistruar të gjithë banesën në Hipotekë, në nene {\*\*\*}, datë 08.02.1994 dhe {\*\*\*}, datë 13.04.1995 tek unë si pronar gjithë banesa. Këtë banesë, duke filluar që nga koha që kam banuar dhe pas dhurimit nga nëna, e pjesës tjetër nga vjehri, në vazhdimësi e kam rikonstruktuar, duke i hequr çatinë ekzistuese (papafingo), duke e bërë çati (papafingo) të re, me ambiente të përshkruara në certifikatën përfundimtare të pronësisë, shënuar në fillim të përshkrimit, lëshuar nga ZVRPP Vlorë, datë 21.11.2007, nr. pasurie {\*\*\*}, z.k. nr. {\*\*\*}. Rikonstruktuar me shpenzimet e kryera nga data 04.12.1992 deri në dhjetor 2004. Të ardhurat e siguruara nga puna: para datës 04.12.1992 kam qenë gjithmonë i angazhuar në punë me pagë dhe të ardhura më vete: Në Ndërmarrjen e Shpendëve Vlorë nga 29.06.1983 – 28.08.1984. Sekretar gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë nga data 28.08.1984 deri më 16.03.1988. Përmbarues gjyqësor deri në datën 31 tetor 1990. Në këtë datë të fundit, kaluar avokat në Kolegjin e Avokatëve Vlorë, emërimet nga Ministria e Drejtësisë, periudha 31 tetor 1990 deri në gusht 1991, datë në të cilën kam shkuar emigrant në Greqi, me vizë nga Ministria e Shëndetësisë për vizitë mjekësore të kunatit R. R., kthyer në nëntor 1991, hyrje përsëri në fund të nëntorit 1991, kthim me 1 mars 1992. Në Greqi kam punuar në punë të ndryshme, kryesisht punë krahu e dizeno në qytetet Nafpako e Itaka, Greqi, banuar në banesë me qira tek sahati i qytetit dhe në Itaka tek një banesë ish-shkollë. Emri i pronarit në Nafpako, X. C. “P{\*\*\*}”, punuar punë dizeno e transport mallrash. Po në Nefkapo tek pronar K. S. SH– Nafpako. Në Itaka, Greqi, mbledhje ullinj, tek pronar mësues shkolle, i ati mësues i vjetër i qytetit Itaka, shkolla e vjetër si muze në periferi të qytetit. Të ardhura nga puna në Greqi 1.000.000 drahmi, të konvertuara në lekë 1 x 5 = 500.000 lekë. Gjithashtu, periudhën 1984 e më pas kam pasur gjithmonë depozita kursimi në bankë, ku depozitat kanë qenë me interesa të larta nga 12% deri në 30%. Vazhduar punën në Kolegjin e Avokatëve deri në daljen si avokat privat me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 02.05.1992, person fizik, me nr. serial {\*\*\*}. Paguar rregullisht tatimet dhe sigurimet shoqërore si avokat deri në datën 06.03.2000 kur kalova gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë e vazhdoj edhe sot. Shpenzime për pasurinë nr. {\*\*\*}, sipas situacionit periudha 01.01.2003 – 31.12.2005, sipas faturave e deklaratave që disponoj të punimeve, duke zbritur vlerën e banesës ekzistuese (me akt dhurimi) rikonstruktuar, është në shumën 1.668.540 lekë”.

deklarim të pasaktë dhe kontradiktor lidhur me vlerën e investimit të bërë në këtë pasuri, por pavarësisht kësaj, nga analiza financiare bazuar në situacionin e punimeve të vëna në dispozicion, ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme të realizojë investimet në ndërtesë gjatë viteve 2000-2005, duke rezultuar në pamundësi financiare prej (-) 1.668.540 lekësh.

**40.3.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se vlerësimi i Komisionit se, *kjo pasuri nuk është deklaruar saktë sepse ka pasaktësi në deklaratimet periodike lidhur me origjinën e krijimit të pronës, ku dhurimin e 1/2 nga vjehri e deklaroi vetëm në deklaratën vetting, duke penguar vlerësimin e plotë dhe të saktë të burimit të krijimit të kësaj pasurie, në kuptim të ligjit nr. 84/2016*, është alogjik. Sipas subjektit, me deklarimin e kësaj pasurie në deklaratën *vetting* nuk është krijuar asnjë pengesë për të hetuar në mënyrë të plotë këtë pasuri, madje në fillim të hetimit administrativ janë vënë në dispozicion të dhëna të plota për burimin e krijimit të pasurisë, dhe Komisioni nuk mund të citojë një pasaktësi në deklaratën fillestare të pasurisë, e cila është sqaruar në vijimësi me ILDKPKI-në. Të ardhurat për krijimin e kësaj pasurie kanë qenë të mjaftueshme dhe të ligjshme, nëse vlerësohen sipas analizës financiare të paraqitur prej tij si provë në Komision, si edhe me njohjen e të ardhurave të tjera të ligjshme që padrejtësisht nuk janë njohur prej Komisionit, pretendoi subjekti.

**40.4.** Trupi gjykues, nga aktet në dosjen gjyqësore, konstaton se subjektit citon dhe kundërshton gjetjen e Komisionit për të cilën subjektit i ka kaluar barrën e provës. Referuar vendimit objekt shqyrtimi, për këtë pasuri, konstatohet se pas pasqyrimin të qëndrimit të subjektit në përgjigje të barrës së provës, në vlerësimin përfundimtar, Komisioni nuk konkludon për mosdeklarimin e dhurimit të 1/2 pjesë nga vjehri në deklaratimet periodike, por vetëm për mungesën e këtij deklarimi në deklaratën *vetting*, si pengesë për vlerësimin e plotë dhe të saktë të burimit të krijimit të kësaj pasurie, në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Komisioni, pas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, në parashtrime dhe në seancë dëgjimore, ka vlerësuar se subjekti ka bërë deklarim të pasaktë lidhur me vlerën e investimit në këtë pasuri, konkluzion i cili gjendet i drejtë nga trupi gjykues. Konkretisht, nga aktet në dosjen gjyqësore rezulton si vijon: Në deklaratën e vitit 2003, subjekti e deklaroi këtë pasuri: *“banesë dy dhoma, një guzhinë me sipërfaqe 200 m<sup>2</sup> +ndërtimi kati i dytë, dy dhoma, banjo, depo me konstruktion të lehtë. Vlera: 4 milion lekë. Nr. datë regjistri në hipotekë (nëse ka): nr. {\*\*\*}, datë 08.02.1994 dhe 2386, datë 13.04.1995. Burimi: Akt dhurimi 1/2 e banesës nga nëna P. S. në vitin 1992”*. Në deklaratat periodike të viteve 2003-2005, subjekti nuk ka deklaruar shtesa/ndryshime apo shpenzime në lidhje me këtë pasuri, ndërkohë në deklaratën *vetting* deklaroi shpenzime rikonstruksioni sipas situacionit *periudha 01.01.2003-31.12.2005* në shumën 1.668.540 lekë<sup>48</sup>. Në parashtrimet në Komision, subjekti deklaroi: *“[...] banesë e cila ishte 100 vjeçare (rrezik shembje) të cilën e kam rindërtuar [...]. E rindërtova këtë banesë me të ardhura nga emigracioni në Greqi [...]. Vlera e rikonstruksionit në shumën 1.668.540 lekë është mbuluar me të ardhura të ligjshme”*. Sa më sipër, duke evidentuar se në DVP 2003 subjekti deklaroi të dhënat e dy akt dhurimeve, atë nga nëna dhe atë nga vjehri, por si burim deklaroi vetëm akt dhurimin e 1/2 pjesë nga nëna, lidhur me rikonstruksionin, vlera e deklaruar në deklaratën e vitit 2003 është e ndryshme nga

---

<sup>48</sup> Me deklaratën *vetting* dhe pranë Komisionit, për të vërtetuar shpenzimet e kryera në këtë pasuri, subjekti ka depozituar fotokopje të situacionit të shpenzimeve për periudhën 01.01.2003-31.12.2005, me objekt *“Rikonstruksion çatie dhe punime të brendshme, me investitor shtetasin Hektor Sinanaj dhe zbatues shtetasin A. D., në shumën 1.668.540 lekë, si dhe foto të jashtme të papafingos të shtëpisë.*

ajo e deklaruar në deklaratën *vetting*. Pavarësisht kësaj, Komisioni ka kryer analizën financiare bazuar në situacionin e punimeve të vënë në dispozicion prej subjektit, për të cilin subjekti nuk ka pretendime. Lidhur me *pretendimet e subjektit për njohje të të ardhurave të tjera të ligjshme që padrejtësisht nuk janë njohur prej Komisionit*, është analizuar gjerësisht në këtë vendim, e duke shmangur përsëritjen e tyre, trupi gjykues, edhe në këtë rast, i vlerëson pretendimet e subjektit, të pabazuara.

#### 41. *Pasuria automjet tip “{\*\*\*}”, me targa {\*\*\*}*

41.1. Në deklaratën *vetting*, lidhur me këtë pasuri, subjekti deklaron: “*Automjet “{\*\*\*}”, blerë me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.05.2008, nga pala kredithënëse “{\*\*\*}, në shumën 23.000 euro, shlyer me këste mujore 357 euro në muaj për 5 vjet kohë. Targa: {\*\*\*}. Vlera: 23.000 euro. Pjesë takuese: 100%*”.

41.2. Komisioni ka çmuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me vlerën e blerjes së automjetit, dhe në përfundim ka vlerësuar se subjekti nuk arriti të provojë se burimet për krijimin e kësaj pasurie kanë qenë të krijuara në mënyrë të ligjshme, referuar standardit dhe kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

41.3. Subjekti pretendon se për pasurinë automjet tip “{\*\*\*}” blerë në shumën 23.000 euro, me këste mujore 357 euro/muaj për 5 vjet, i është referuar çmimit të kontratës së blerjes, ndërsa për çmimin përfundimtar të paguar është vënë në dijeni me informacionin e dhënë prej Komisionit, *i cili ka llogaritur këstet së bashku me interesat*. Sipas tij, për faktin që shuma e të gjithë kësteve ka rezultuar më e lartë se ajo e blerjes, nuk mund të marrë informacion të detajuar për shkak se subjekti tregtar shitës, ka mbyllur aktivitetin dhe nuk mund të sigurojë informacion të saktë për arsyet e diferencës. Edhe për këtë pasuri, subjekti pretendon se nëse do të rivlerësohen të ardhurat e refuzuara prej Komisionit, bilanci negativ për krijimin e kësaj pasurie do të ndryshonte.

41.4. Trupi gjykues, nga aktet në dosjen gjyqësore konstaton *së pari*, se me deklaratën *vetting* subjekti ka dorëzuar “*Kontratë themelore e qirasë financiare (leasing), nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.05.2008, lidhur mes tij në cilësinë e qiramarrësit dhe shoqërisë “{\*\*\*}” SHA, në cilësinë e qiradhënësit me objekt: “Dhënie me qira financiare të një sendi të përzgjedhur nga qiramarrësi”. Në shtojcën nr. 1 bashkëlidhur kontratës, sendi i përzgjedhur është automjeti tip “{\*\*\*}”, ngjyrë gri, me targë {\*\*\*}. Vlera e sendit të marrë me qira: 24.000 euro<sup>49</sup>. Në vitin 2013, pas pagesës së vlerës së detyrimit të kontratës së mësipërme, në datën 16.03.2013, palët kontraktore kanë lidhur kontratën e shitblerjes së automjetit ngjyrë gri, me targë {\*\*\*}, kundrejt çmimit 693 euro, sipas kontratës likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale. *Së dyti*, në DVP-në e vitit 2008 subjekti e deklaroi këtë pasuri/automjet të blerë me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.05.2008, *paguar 30% e vlerës 7.200 euro, pjesa tjetër për 5 vjet kohë me 357 euro në muaj. Gjithsej ngelur pa shlyer 13.000 euro; në DPV-të e viteve 2009-2013, deklaroi shlyerjen e leasing; në DPV 2021 deklaroi: automjet burimi i krijimit: të ardhura 23.000 Euro. Burimi i fondeve janë kursime familjare dhe hua nga shtetasi Z. NJ. G.**

<sup>49</sup> Referuar kontratës, vlera përfundimtare e sendit të marrë me qira, që përbën edhe bazën e përlllogaritjes së pagesave të qirasë, përcaktohet pas përfundimit të procedurës së marrjes së tyre, në bazë të shumës së shpenzimeve që ka bërë qiradhënësi për fitimin e tyre. Qiraja e parë e barabartë me 30% të vlerës përfundimtare të sendit është paguar në vitin 2008, ndërsa qiratë në vijim do të paguhen duke filluar nga data 02.06.2008 në çdo datë 2 të çdo muaji në vazhdim. Të gjitha pagesat sipas kontratës janë bërë në Tirana Bank.

në vlerën 4.500 euro dhe 300.000 lekë të përfituar si kthim huaje nga vjehrrri S. R.. Së treti, në Komision, gjatë hetimit administrativ<sup>50</sup>, subjekti deklaroi: se arsyeja e deklarimit të vlerës së këtij automjeti 23.000 euro, që çmimin nga firma e kishte 24.000 euro, është se pronari është shprehur se ul çmimin 1.000 euro, por kur është paraqitur në firmë nuk ka rezultuar të kishte ulje. Më tej, vijon se nga arkëtimet e kryera së bashku me interesat është shuma 30.581 euro, si dhe shpjegon në mënyrë të detajuar arkëtimet e bëra prej tij, të dokumentuara. Në prapësimet për rezultatet e hetimit administrativ kryesisht, subjekti nuk ka dhënë shpjegime lidhur me barrën e provës së kaluar për këtë pasuri, konkretisht për mospërputhjet e vlerës së deklaruar të mjetit me vlerën në kontratë dhe vlerën e shpenzimeve përfundimtare, si dhe për pamundësinë financiare të rezultuar për krijimin e kësaj pasurie, për të gjithë vlerën e blerjes së saj, prej (-) 24.000 eurosh.

**41.5.** Sa më sipër, trupi gjykues i gjen të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit se për çmimin përfundimtar të paguar është vënë në dijeni me informacionin e dhënë prej Komisionit, i cili ka llogaritur kështu së bashku me interesat, pasi vetë ai në përgjigje të pyetësorit nr. {\*\*\*}, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, ka deklaruar vlerën totale të shpenzuar, prej 30.581 eurosh. Për më tepër, lidhur me mosdeklarimin e saktë të vlerës së pasqyruar në kontratë prej 24.000 eurosh pretendimet e subjektit se pronari është shprehur se ul çmimin 1.000 euro, por kur është paraqitur në firmë nuk ka rezultuar të kishte ulje, përpos të pakuptimita, vlerësohen se mbeten në nivel deklarativ.

**41.6.** Subjekti i rivlerësimit, pretendoi se pa u ndalur në detaje edhe për pasuritë e tjera të cilat janë vlerësuar me mangësi në të ardhurat, nëse do të rivlerësohen me të gjithë komponentët e të ardhurave që pretendohen në këtë ankim, bilanci negativ që do të rezultonte prej analizës do të ndryshonte. Trupi gjykues, në këndvështrim të qëndrimeve të mbajtura si më lart, konfirmon sërish konkluzionet e Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme në krijimin e pasurive të renditura në vendimin objekt kontrolli, për pasurinë automjet tip “{\*\*\*}”, si edhe për pasuritë për të cilat subjekti nuk parashtron shkaqe konkrete apo pretendime të veçanta<sup>51</sup>, situatë që e vendos subjektin në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i subjektit, vlerësohet i pabazuar.

## **42. Analiza financiare mars 2000-2016**

**42.1.** Komisioni ka çmuar se në përputhje me arsyetimin e bërë në vendim, subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të pasurive të krijuara prej tij dhe personave të lidhur, duke mos arritur të përmbysë barrën e provës të kaluar, dhe duke vazhduar të ketë pamundësinë financiare në vlerën (-) 26.527.843 lekë, për periudhën 2003-2016. Ndërsa, lidhur me analizën financiare të periudhës mars 2000-2002, në vijim të arsyetimit të bërë në vendim, Komisioni ka përfshirë të ardhura nga avokatia me marzh fitimi 90% për periudhën shtator 1992-1999, të llogaritura në vlerën totale 13.500.000 lekë, e për pasojë, për periudhën 1992-2002, pamundësia financiare e subjektit është reduktuar në vlerën (-) 2.374.543 lekë.

<sup>50</sup> Pyetësori {\*\*\*}, pyetja nr. 2

<sup>51</sup> Për pasuritë automjet tip “{\*\*\*}” me targë {\*\*\*}, blerë në datën 30.07.2013, në shumën 3.500 euro; depozita me afat njëvjeçar në Bankën Amerikane të Investimeve respektivisht në shumën 10.000 euro dhe 20.000 euro; depozitë me afat njëvjeçar në BKT në shumën 2.500.000 lekë; gjendje kursimesh cash deklaruar në shumën 8.000 euro dhe 300.000 lekë.

42.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka kryer analizën financiare bazuar në aludime, duke paragjykuar rezultatet përfundimtare të saj, dhe me gabime të rënda materiale, dhe se investimet në gjendjen reale janë pasqyruar saktësisht në analizën financiare të ekspertit kontabël të dorëzuar si provë në këtë proces. Sipas tij, Komisioni: (i) ka shtuar shpenzimet e jetesës duke mos vlerësuar asnjë rrethanë të prezantuar e provuar prej tij; (ii) shpenzimet e udhëtimit dhe të pushimeve janë shtuar në vlerë të konsiderueshme, në kundërshtim me faktet, pasi në Itali kanë qëndruar në banesën e një kushëriri, mund të verifikohet lehtësisht se kanë udhëtuar me xhaxhain Q. S., rezident në Itali, dhe ne kanë qëndruar në shtëpinë e djalit të tij në Milano, familja e të cilit ishte me pushime verore, ndërsa në Greqi kanë qëndruar tek shtëpia e vëllait të bashkëshortes R. R., piktor i suksesshëm e me gjendje të mirë ekonomike; (iii) në analizën financiare për vitet 2001-2003 nuk janë pasqyruar tërheqjet nga depozitat bankare të asaj periudhe, të provuara me shkresën e datës 20.03.2023 të Raiffeisen Bank.

42.3. Trupi gjykues *së pari* konstaton se referuar analizës financiare të kryer nga eksperti kontabël në datë 17.02.2024, depozituar nga subjekti në cilësinë e provës me prapësimet në Komision, subjekti rezulton me balancë negative në shumën (-) 2.924.219 lekë. Për rrjedhojë, edhe në opsionin që mbështetet në variantet e prezantuara prej subjektit lidhur me krijimin e pasurive, sërish ai rezulton me pamjaftueshmëri financiare për të krijuar pasuritë dhe për të përballuar shpenzimet familjare.

*Së dyti*, lidhur me pretendimet për shtim të shpenzimeve të udhëtimit dhe të pushimeve, konstatohet se në Komision subjekti ka deklaruar<sup>52</sup>: “*Dalje në datën 31.07.2009 nga Pika e Kalimit Kufitar (më tej PKK) në Portin Vlorë për udhëtim turistik në Itali dhe Hyrja në datë 13.08.2009 në PKK Kakavijë. Ky udhëtim ka pasur qëllim turistik dhe vizitë tek familjarë. Në Itali ka qëndruar në Milano në shtëpinë e kushëririt të tij z. G. S., i cili vendosi në dispozicion të gjithë banesën e tij me adresë ‘{\*\*\*}’, Milano. Në Itali ka udhëtuar së bashku me xhaxhain, z. Q. S. Gjithashtu ka qëndruar edhe në Athinë tek shtëpia e kunatit, z. R. R. me adresë ‘{\*\*\*}’, Athinë. Këtë banesë Z. R. e ka vendosur në shitje pasi ka emigruar me familjen në Kanada. Udhëtimet brenda Italisë i kanë kryer me tren, me traget dhe udhëtimet në Greqi me autobus. Shpenzimet për këtë udhëtim kanë qenë 3.100 euro*”. Në analizën financiare të kryer nga eksperti kontabël z. A. M., datë 17.02.2024, depozituar nga subjekti me prapësimet në Komision, totali i shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2009 është përllogaritur në shumën 425.227 lekë<sup>53</sup>, duke ju referuar shumës së deklaruar nga subjekti në pyetësonin standard, ndërsa Komisioni i ka përllogaritur ato në shumën 523.657 lekë<sup>54</sup>, sipas metodologjisë së përdorur nga organet e rivlerësimit. Përpos se subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues lidhur me sa pretendon për qëndrim tek të afërmit, diferenca prej 98.430 lekësh (718 euro) mes shumës së përllogaritur prej Komisionit me atë të përllogaritur prej ekspertit, tregon se vetë subjekti ka përllogaritur kosto për qëndrimin 14 ditor jashtë vendit, në të kundërt kjo diferencë do të ishte shumë më e madhe<sup>55</sup>.

<sup>52</sup> Në përgjigje të pyetësonit standard, pyetja nr. {\*\*\*}.

<sup>53</sup> 3.100 euro \* k.k 137.17 = 425.227 lekë.

<sup>54</sup> 3.818 euro \* k.k 137.17 = 523.657 lekë.

<sup>55</sup> Për qëndrim 14-ditor, vetëm për 1 person duke përllogaritur kosto qëndrimi me 50 euro/ditë dhe me 5 euro/ditë, diferenca do të rezultonte 86.417 lekë (700 euro-70 euro = 630 euro), shumë kjo e përafërt me diferencën e shumës së përllogaritur nga Komisioni dhe subjekti, ndërkohë që subjekti ka udhëtuar së bashku me bashkëshorten dhe tre fëmijët, çka do të bënte që diferenca në total të ishte 2.520 euro dhe jo ajo e pretenduar nga subjekti në shumën 718 euro.

*Së treti*, sikundër analizuar më lart në këtë vendim, lidhur me shpenzimet e jetesës, trupi gjykues gjeti të drejtë pretendimet e subjektit vetëm për ato të periudhës 1992-1999, sikundër gjeti të drejtë edhe pretendimin për depozitën bankare dhe shumën e tërhequr sipas informacionit të Raiffeisen Bank me shkresën e datës 20.03.2023 dhe, për pasojë, bëri korrigjimet përkatës në analizën financiare të Komisionit.

**42.4.** Në përfundim, lidhur me analizën financiare të Komisionit, përpos korrektiveve për sa më lart pasqyruar në këtë vendim, dhe moskonsiderimit të pretendimeve që lidhen me shpenzimet e udhëtimit në vitin 2009, si të paprovuara, trupi gjykues pasi e kontrollloi atë nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, arriti në konkluzionin se shuhet balanca negative e konstatuar prej Komisionit për periudhën 1992-2002, dhe se konfirmohet një balancë negative në vlerën prej (-) 24.234.062 lekësh për analizën financiare për vitet 2003-2016. Edhe nëse në një qëndrim tejet garantist, do të vlerësohej të njiheshin të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet e qirasë sipas informacionit shkresor të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë të paraqitur prej subjektit me ankimin, totali i balancës negative për periudhën në analizë do të shkonte në vlerën prej (-) 18.240.897 lekësh, duke e vendosur subjektin në çdo rast para parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

**42.5.** Në mbështetje e vlerësim të konkluzioneve të mësipërme, trupi gjykues arriti në përfundimin, se pasaktësitë në deklarinimin e pasurive si dhe balancat negative të konstatuara për justifikimin e pasurive të përshkruara më lart dhe përbalimin e shpenzimeve, e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

#### ***D. Vlerësimi për shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale***

- 43.** Trupi gjykues pasi analizoi shkaqet e ankimit të subjektit lidhur me këtë kriter, konstatoi se ato drejtohen në mënyrë specifike në dy çështje që i përkasin dokumenteve 1 dhe 2, të paraqitur prej tij në kuadër të kontrollit të këtij kriteri dhe bëjnë një vlerësim kundërshtues të konkluzioneve të tjera të Komisionit lidhur me këtë kriter, pa adresuar shkaqe konkrete apo pretendime të veçanta për secilin konkluzion. Konkretisht, duke u shprehur *se në të gjitha rastet përfundimet e Komisionit janë stereotipe duke përsëritur disa herë që subjekti nuk parashtrroi asnjë argument ndërkohë që argumentet janë të qarta për sa i përket mënyrës së arsytimit të gjyqtarit*, subjekti në mënyrë të përgjithshme, pretendoi për pabazueshmëri të vlerësimit të Komisionit me argumentin se përse gjykata nuk ka arsytuar se caktimi i një mase tjetër dënimi është e pazbatueshme, për sa kohë nga gjyqtari është arsytuar caktimi i një lloji dhe mase dënimi.

**43.1.** Trupi gjykues, *së pari* konstaton se edhe në përgjigje të rezultateve të hetimit kryesisht të Komisionit, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në ankim, duke mos dhënë shpjegime për pjesën më të madhe të çështjeve të kaluara si barrë prove me këtë raport e për pasojë, duke hequr dorë nga mbrojtja apo kontestimi i këtyre rezultateve. Në kushtet e mungesës së paraqitjes së ndonjë pretendimi ose prove konkrete bindëse që do të tregonte pabazueshmërinë e arsytimit dhe të vlerësimit të Komisionit për çështjet gjyqësore të shqyrtuara e vlerësuara në vendimin objekt gjykimi, pa një kontroll të thelluar por, sipas një vështrimi konstatues, konkluzionet e Komisionit që i përkasin kriterit të aftësive profesionale, përfshirë edhe ato për dokumentet 1 dhe 2 për të cilat vlerësimi në vijim bazohet mbi shkaqet e ankimit të subjektit,

të cilat janë kualifikuar nën optikën e nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, gjenden prej trupit gjykues të drejta, dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit vlerësohen të pabazuara.

**43.2.** *Së dyti*, trupi gjykues, duke gjetur të drejta konkluzionet e Komisionit në të dyja çështjet e kontestuara prej subjektit, që lidhen me vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, atë penal nr. {\*\*\*}, datë 27.03.2014, dhe atë civil nr. {\*\*\*}, datë 22.02.2016, gjen haptazi të pabazuara pretendimet e subjektit se në rastin e vendimit penal sipërcituar, Komisioni nuk ka hetuar lidhur me sqarimet e tij se ka qenë në pakicë në vendimmarrje, dhe se në rastin e dytë, atë të vendimit civil, Komisioni ka shfaqur qëndrime subjektive me asnjë të dhënë konkrete për të mbështetur argumentet. Konkretisht:

**43.2.1.** Lidhur me dokumentin 1, vendimi gjyqësor penal nr. {\*\*\*}, datë 27.03.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka miratuar kërkesën për gjykim të shkurtuar, dhe në përfundim të gjykimit ka vendosur “Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit M. R., për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/4 i Kodit Penal dhe për kryerjen e veprës penale “Kanosje” në dëm të shtetasve J. M. dhe A. S., parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, për shkak se nuk provohet që i pandehuri të ketë kryer veprat penale për të cilat akuzohet, dhe ka urdhëruar lirimin e menjëhershëm të të pandehurit M. R. nga IEVP Vlorë, nëse nuk mbahet i ndaluar apo i arrestuar për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale. Referuar përmbajtjes së vendimit, konstatohet se subjekti dhe dy anëtarët e tjerë të trupit gjykues, megjithëse kanë konstatuar se i pandehuri pretendonte pavlefshmëri të një akti procedural të ndodhur në këtë dosje, pavlefshmëri e pranuar edhe në arsyetimin e vendimit se “Gjykata gjen të bazuara gjithashtu kundërshtimet për procesverbalin “Për paraqitjen për njohje”, datë 27.9.2013. Nuk janë respektuar kërkesat e neneve 171 e 172 të Kodit të Procedurës Penale mbi njohjen e personave dhe zhvillimin e saj që e bëjnë të pavlefshëm dhe, konkretisht, personi i ftuar për të bërë njohjen nuk ka bërë një përshkrim të personit për të treguar shenjat që mban mend, siç parashikon dispozita e nenit 171/1 të Kodit të Procedurës Penale”, nuk kanë vendosur që të revokonin vendimin për gjykimin e shkurtuar dhe të procedonin me gjykimin e zakonshëm por kanë vijuar me gjykimin e shkurtuar.

**43.2.2.** Komisioni, në analizë të fakteve dhe provave, shpjegimeve të dhëna nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, duke vlerësuar se subjekti gjatë gjykimit të këtij rasti në dhënien e vendimit ka cenuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për gjykimin e shkurtuar, nenet 403 dhe 404, si dhe jurisprudencës unifikuese të Gjykatës së Lartë, ka konkluduar se në këtë rast konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

**43.2.3.** Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë konkluzion, pretendon se Komisioni nuk ka dhënë asnjë shpjegim dhe nuk ka kryer asnjë hetim për sqarimin e dhënë prej tij *se në këtë vendimmarrje ka qenë në pakicë, duke qenë se trupa gjyqësore ka qenë e përbërë nga tre gjyqtarë.*

**43.2.4.** Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues *së pari* konstaton se në përgjigje të kërkesës së Komisionit në raportin e rezultateve të hetimit kryesisht, për dhënien e shpjegimeve lidhur me vendimmarrjen e gjykatës për marrjen në shqyrtim dhe, më pas, pranimin e kërkesës së të pandehurit për pavlefshmërinë e një akti procedural, pa revokuar vendimin e gjykimit të shkurtuar, duke cenuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për gjykimin e shkurtuar, nenet

403 dhe 404, si dhe jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, subjekti është shprehur se qëndron arsyetimi i dhënë nga Komisioni dhe ka shpjeguar se ka debatuar me iniciativën e tij si kryesues për revokimin e gjykimit të shkurtuar, por shumica e trupës gjykuese nuk ka qenë dakord me revokimin e gjykimit të shkurtuar dhe se ky vendim është paraqitur prej vetë atij për shkak të arsyetimit të një vendimi që bie ndesh me qëndrimin e akuzës për fajësi dhe gjykata ka argumentuar me një arsyetim ligjor të kundërtën, dhënien e pafajësisë me argumente që përbëjnë një vlerësim për t'u pasur parasysh në jurisprudencë, qëndrim i pasqyruar në vendimin objekt gjykimi. Së dyti, subjekti duke u shprehur në Komision se ka debatuar me iniciativën e tij si kryesues për revokimin e gjykimit të shkurtuar dhe në ankim se në këtë vendimmarrje ka qenë në pakicë, ndryshon qëndrim në favor të pretendimit të tij, i cili në të dy rastet mbetet deklarativ dhe i paprovuar referuar vendimit të Gjykatës. Përpos se nuk është vendosur revokimi megjithëse është konstatuar dhe pranuar pavlefshmëria e një akti procedural, duke vepruar në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 2, datë 29.01.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili ka unifikuar praktikën gjyqësore se: “Në rast se palët kanë pretendime lidhur me pavlefshmërinë e akteve qofshin pavlefshëmri absolute apo relative dhe kërkojnë konstatimin e kësaj pavlefshmërie, gjykata duhet të revokojë vendimin për gjykim të shkurtuar dhe të urdhërojë vazhdimin e procedimit me gjykim të zakonshëm”, duke arsyetuar pafajësinë e të pandehurit, subjekti ka shkelur parimin e kontradiktoritetit duke i pamundësuar palës akuzuese mbrojtjen e akuzës në kushtet e reja të pavlefshmërisë së aktit procedural. Në këto rrethana faktike dhe ligjore, ku qartazi evidentohen mangësi të gjyqtarit/subjektit në aftësitë e tij për arsyetimin e vendimit, në analizën e dispozitave ligjore dhe provave të administruara, pretendimet e subjektit se Komisioni nuk ka kryer hetim mbi sqarimet e tij vlerësohen prej trupit gjykues përpos të pakuptimita, të pabazuara, dhe konkluzioni i Komisionit, i drejtë.

**43.3.** Lidhur me dokumentin 2, vendimi gjyqësor civil nr. {\*\*\*}, datë 22.02.2016, i Gjykatës së Rrethit Vlorë, me objekt “Pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë, anulimin e veprimeve përmbarrimore, marrjen e masës provizore të sigurimit të padisë duke pezulluar veprimet përmbarrimore”, në përfundim të gjykimit, gjykata ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë.

**43.3.1.** Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka kryer një proces gjykimi bazuar në prova, se ka mbyllur procesin e gjykimit mbi një akt ekspertimi me të meta, se vendimi përfundimtar nuk është i arsyetuar qartë e në mënyrë të kuptueshme, në të mungon analiza e provave dhe argumentimi logjik, dhe se subjekti, në arsyetim, zgjidhjen e kontratës në mënyrë të njëanshme nga pala e paditur e konsideron në formën e vetëgjyqësisë, duke ngatërruar kështu konceptet e së drejtës civile me ato të së drejtës penale. Lidhur me argumentet e subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit se: “[...] është arsyetuar për të gjitha pretendimet e bazuara dhe që kanë sjellë debat gjyqësor. Për sa i përket përdorimit të termave të së drejtës penale në një proces civil, këto terma nuk duhet të shkëputen nga konteksti për t'u krahasuar me terma të ngjashëm në procesin penal. [...] Fakti që nuk mohoj se kam përdorur në fjalinë “Vetëgjyqësi”, duhet të përdorja fjalën “Vetëgjykim”[...]. Komisioni ka vlerësuar se lidhur me përdorimin e terminologjisë së gabuar, argumentet e subjektit nuk rrëzojnë barrën e provës lidhur me këtë fakt, dhe se subjekti nuk parashtrroi asnjë argument lidhur me konstatimet e tjera. Mbi këto vlerësime, Komisioni ka çmuar se nga subjekti konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

43.3.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka shfaqur qëndrime subjektive në vlerësimin e procesit gjyqësor duke mos e bazuar në asnjë të dhënë konkrete, madje cilëson vetëm përdorimin e fjalës “vetëgjyqësi”, duke e marrë të shkëputur nga konteksti dhe duke e cilësuar problematike.

43.3.3. Trupi gjykues, nga shqyrtimi i këtij vendimi gjyqësor të marrë prej subjektit, konstaton se: në pjesën arsyetuese nuk pasqyrohen të renditura pretendimet e palës paditëse, nuk pasqyrohen fare pretendimet e palës së paditur, nuk arrihet të qartësohen provat që palët kanë paraqitur në mbështetje të pretendimeve/prapësimeve, pretendimet dhe prapësimet e palëve nuk analizohen në raport me dispozitat e cituara në vendim, konstatohet se është kryer një ekspertizë kontabël përmbajtja e së cilës është përfshirë e gjitha në vendim pa u analizuar në lidhje me të si provë, subjekti/gjyqtari pranon se akti i ekspertimit paraqitet me të meta pa argumentuar si ndikojnë ato në zgjidhjen e çështjes, apo nëse ishte e nevojshme që akti të plotësohej, kërkesa e bankës për lëshimin e urdhrit ekzekutiv për titullin ekzekutiv “kontratë bankare” konsiderohet si zgjidhje kontrate, si më pas kjo zgjidhje e kontratës në mënyrë të njëanshme nga pala e paditur (Raiffeisen Bank), konsiderohet si “vetëgjyqësi”. Për të gjithë mangësitë e renditura në mënyrë të përmbledhur si më sipër, që vlerësohen si probleme në arsyetimin e vendimit, me pasojë në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit, sipas parashikimeve të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, pretendimi i subjektit *për qëndrime subjektive të Komisionit në vlerësim duke mos e bazuar në asnjë të dhënë konkrete*, vlerësohet prej trupit gjykues haptazi i pabazuar.

43.4. Subjekti pretendoi se *prej Komisionit janë cituar dy procedime të mëparshme disiplinore ndaj tij, pa një arsye konkrete sesi këto masa të mëparshme mund të ndikojnë në procesin e rivlerësimit, aq më tepër për t'i cituar si gjetje të mangësive profesionale të subjektit sepse do të cenohej parimi i gjësë së gjykuar*. Edhe ky pretendim i subjektit, përpos se i pakuptimtë, vlerësohet prej trupit gjykues haptazi i pabazuar. Referuar dispozitave të Kreut IV të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për vlerësimin e aftësive profesionale, ku përfshihet edhe informacioni që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale të subjektit që i nënshtrohet rivlerësimit kalimtar. Në konsideratë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, kjo e fundit ka mbajtur qëndrim se organet e rivlerësimit, Komisioni në këtë rast, në kryerjen e funksionit kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e organeve të tjera ndihmëse. Në këtë kontekst, Komisioni ka realizuar një hetim të pavarur në lidhje me këtë kriter, duke referuar të dhënat nga burimet arkivore të KLGj-së, nga ku ka rezultuar se nga ky organ ndaj subjektit Hektor Sinanaj janë marrë dy masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” me vendimet respektivisht nr. {\*\*\*}, datë 16.07.2004 dhe {\*\*\*}, datë 16.07.2004. Këto masa disiplinore të marra, e para për kryerje të veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, dhe e dyta, pas verifikimit të 9 (nëntë) vendimeve penale të gjykuara nga trup gjykues në përbërje të së cilit ka qenë edhe subjekti Hektor Sinanaj, bëhen prezent në vendimin objekt shqyrtimi në kontekst të problematikave të shfaqura prej subjektit të rivlerësimit në përmbushjen e rregullt të detyrës. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se citimi i tyre si gjetje të mangësive profesionale cenon parimin e *gjësë së gjykuar*, vlerësohet prej trupit gjykues i pabazuar.

44. Lidhur me pretendimin se *për denoncimet e cituara nga Komisioni, gjetjet e prezantuara janë shqyrtuar nga KLGj-ja, ku asnjë prej tyre nuk është gjetur të bazuara për konflikt interesi apo pretendime të tjera, dhe krahasuar me numrin e çështjeve të gjykuara prej tij gjatë 24 viteve,*

*këto denoncime në një numër të papërfillshëm tregojnë besueshmëri të lartë të gjyqtarit tek publiku, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si vijon. Në Komision, për subjektin e rivlerësimit janë administruar 31 denoncime nga publiku, për 12 prej të cilave subjektit i janë kërkuar shpjegime e për të cilat ai nuk ka dhënë shpjegime. Nga denoncimet e shqyrtuara prej Komisionit, tre prej tyre kanë pasur objekt çështjen e konfliktit të interesit pikërisht për shkak se palët ndërgjyqëse kanë qenë qiramarrës të ambienteve të zyrave në pronësi të subjektit. Konsideruar rëndësinë që kushtetutëbërësi dhe legjislatori i ka dhënë pjesëmarrjes së publikut në procesin e rivlerësimit kalimtar, qëllimit të këtij procesi për kthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, pretendimet e subjektit që synon të relativizojë problematikën duke referuar në raportin mes numrit të çështjeve të gjykuara prej tij me numrin e denoncimeve, vlerësohen të pakuptimta dhe të papranueshëm.*

#### ***Lidhur me konfliktin e interesit***

45. Referuar rasteve të mbi 180 çështjeve gjyqësore, të natyrave të ndryshme, të gjykuara prej subjektit, ku përfaqësues të palëve ndërgjyqëse kanë qenë kryesisht avokatë dhe ekspertë, të cilët kanë marrë ambiente me qira në godinën 3-katëshe në pronësi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të vazhdueshëm të interesit në gjykimin e këtyre çështjeve. Konkretisht:

45.1. Sjellja gjyqësore e subjektit vlerësohet nga trupi gjykues se bie ndesh me parashikimet e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, me dispozitat procedurale civile e penale që detyrojnë/sugjerojnë përjashtimin e gjyqtarit nga trupi gjykues, me synim garantimin e një procesi të rregullt ligjor dhe zbatimin e parimit të së drejtës se *drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe të duket se po jepet*. Subjekti rezulton se është sjellë pa asnjë kujdes në drejtim të shmangies së situatave të konfliktit të interesit në vite dhe ka përcjellë për palët gjyqësore, si edhe për publikun në përgjithësi, së paku pasiguri dhe dyshim se një çështje po gjykohet me drejtësi e paanësi, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Trupi gjykues e sheh këtë problematikë si të kualifikueshme nën optikën e nenit 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 që afekton nënindikatorin e paanësisë, e që ndikon drejtpërsëdrejti në vlerësimin e subjektit lidhur me kriterin e aftësive profesionale.

45.2. Për sa më lart, trupi gjykues, në këndvështrim edhe të qëndrimeve në të njëjtën linjë të pasqyruara në raportin e hartuar prej Këshillit të Lartë Gjyqësor, konfirmon konkluzionin e Komisionit se subjekti nuk arrin një nivel kualifikues në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale dhe gjendet në kushtet e nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

#### ***DH. Vlerësimi tërësor***

46. Lidhur me konkluzionin e nxjerrë sipas një vlerësimi të përgjithshëm të tri kriterëve, trupi gjykues konstaton se ai përmban në brendi të tij të njëjtat shkaqe, për të cilat Komisioni ka konkluduar se subjekti gjendet në kushtet e nenit 61, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë kontekst, trupi gjykues vlerëson se ndonëse shkaqet ekzistojnë siç Komisioni ka konkluduar, ato nuk mund të shërbejnë për t’i rikualifikuar edhe sipas nenit 61, pika 5 të këtij ligji, duke qenë se kanë gjetur përgjigje në drejtim të cilësimit ligjor me të dy dispozitat e mësipërme.
47. Në përfundim, mbështetur në konkluzionet e mësipërme dhe në zbatim të nenit D, pikat 1 dhe 3, të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, si edhe nenit 61, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi

gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka vendosur caktimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, gjendet i bazuar në prova dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 742, datë 13.03.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Hektor Sinanaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 04.11.2025, në Tiranë.

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*